
EKSTREMIZMI FETAR NË MEDIA

Rrapo Zguri

 WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

 Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Tiranë, 2017

WITH FUNDING FROM



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Ky studim u realizua me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), njësisia operacionale e Kooperacionit Austriak për Zhvillim.

Rrapo Zguri

Ekstremizmi fetar në media

Botues:



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Përmbajtja e lëndës

1. Tradita dhe marrëdhëniet ndërfitare në Shqipëri	7
2. Zhvillimet dhe problematika e viteve të tranzicionit	14
3. Kanalet e komunikimit fetar dhe media në Shqipëri	23
3.1. Mediat e komuniteteve fetare	23
3.2. Raportimi për fenë në mediat shqiptare	28
4. Linjat kryesore të diskursit ekstremist fetar në median shqiptare	38
“Më së pari jam mysliman, pastaj shqiptar”	40
Rikontekstualizmi i historisë dhe vënia e saj nën optikën fetare	45
Nga promovimi i salafizmit tek propogandimi i Kalifatit dhe i Sherihatit	52
Islamofobia mes kauzës dhe alibisë	59
Diskursi anti-perëndimor dhe anti-amerikan	65
5. Përmbledhje ekzekutive	72
BIBLIOGRAFI	83

Gjatë viteve të fundit Europa dhe Ballkani kanë qenë të ekspozuar ndaj valës së radikalizmit dhe të ekstremizmit fetar që u rigjallërua sidomos pas nisjes së të ashtuquajturës “luftë e shenjtë” e ISIS në territoret e Sirisë dhe të Irakut. Paralelisht me dhunën e armatosur të ISIS, është zhvilluar një propogandë e gjerë dhe një veprimtari manipuluese dhe rekrutuese edhe në vendet jashtë konfliktit të armatosur, me qëllim zgjerimin e bazës së mbështetësve dhe rekrutëve të kësaj kauze ekstremiste. Reflekse dhe rrjedhoja të kësaj propogande dhe të kësaj veprimtarie rekrutuese janë konstatuar edhe në Shqipëri dhe në hapësirat e tjera shqipfolëse në Ballkan, ku krahas inkurajimit dhe shpërfaqjes së teorive, opinioneve dhe praktikave fundamentaliste, janë verifikuar edhe raste të mercenarizmit fetar. Sipas burimeve zyrtare shqiptare, numri i mercenarëve nga Shqipëria që luftojnë për ISIS ka arritur në 114. Një burim tjetër e çon këtë numër në rreth 150. Situatë e ngjashme vërehet edhe në Kosovë.¹

Rekrutimi dhe mercenarizmi fetar është paraprirë apo bashkëshoqëruar nga një veprimtari propogandistike dhe manipuluese kryesisht në mjedisë të mbyllura dhe në disa objekte të kultit që janë jashtë kontrollit të komuniteteve fetare. Por një propogandë intensive po zhvillohet edhe në mjedisin online.

¹ Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 8, AIIS, Tiranë, 2015

Aktualisht forma më e përhapur dhe më aktive e diskursit fetar ekstremist në Shqipëri, siç rezulton edhe nga kërkimi i kryer në kuadër të këtij studimi si dhe nga studime të tjera, është diskursi ekstremist islamist. Ky diskurs synon të promovojë dhe të nxisë përhapjen e Islamit politik, duke e paraqitur atë si modelin e vetëm dhe të drejtë të organizimit të shoqërisë njerëzore, i cili i tejkalon kufijtë dhe kombet dhe paraqitet si një model universal që do të sfidojë dhe zëvendësojë edhe modelin “në krizë” të shoqërive moderne liberal-demokratike. Gjithashtu diskursi islamist synon që të sfidojë edhe ato tipare dhe vlera specifike të shoqërisë shqiptare të cilat shihen si barriera për modelin shoqëror të Islamit politik.²

Në kontekstin shqiptar, radikalizmi dhe ekstremizmi fetar, edhe pse në fazë embrionale, mund të krijojnë terren për lindjen e konflikteve me bazë fetare, duke cënuar kështu një nga shtyllat kryesore të shoqërisë: harmoninë dhe tolerancën fetare. Njëherësh, përfshirja e Shqipërisë në koalicionin antiterrorist dhe dënimi nga organet e drejtësisë i nxitësve dhe organizatorëve të veprimtarive ekstremiste, ka sjellë shqetësimin se vendi mund të jetë një terren potencial edhe për akte terroriste, siç u provua në rastin e arrestimit të grupit që kishte planifikuar dhunë terroriste gjatë ndeshjes së futbollit Shqipëri-Izrael të zhvilluar në 12 nëntor 2016.

² *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 45, Tiranë 2016

Kjo situatë dhe këto zhvillime kanë bërë të domosdoshme mes të tjerash edhe ndërmarrjen e studimeve dhe të kërkimeve shkencore që hedhin dritë mbi përmasat dhe shkallën e përhapjes së fenomenit dhe ndihmojnë në arritjen e përfundimeve dhe në marrjen e masave për parandalimin apo minimizimin e tij. Këtij qëllimi madhor i shërben edhe ky studim.

Në mënyrë të veçantë studimi fokusohet në diskursin fetar të zhvilluar në media. Objekt i studimit kanë qenë shtypi dhe media online, duke përfshirë në këtë të fundit si portalet dhe websajtet e lajmeve, ashtu edhe mediat sociale online. Por për raste të veçanta dhe ngjarje të rëndësishme janë monitoruar edhe disa programe të kanaleve kryesore televizive. Kërkimi empirik dhe monitorimi i realizuar ka synuar evidentimin dhe kategorizimin e tematikës dhe të ngjarjeve të pasqyruara dhe të raportuara në media si dhe të problemeve që lidhen me këtë raportim. Njëherësh, përmes analizës së përmbajtjes është synuar që të identifikohen linjat dhe termat kryesorë të diskursit ekstremist fetar në mediat shqiptare. Për nevoja të studimit janë ndërmarrë edhe intervista me drejtues apo përfaqësues të komuniteteve fetare, në mënyrë që të shtohet edhe këndvështrimi i tyre në lidhje me çështjet që analizohen këtu.

1

Tradita dhe marrëdhëniet ndërfetare në Shqipëri

Në plan historik, krishterimi ka qenë feja e parë e adoptuar nga shqiptarët, madje ka autorë që theksojnë se krishterimi shqiptar është nga më të vjetrit në të gjithë Europën.³ I ndodhur jo larg qendrës ku lindi feja e krishterë, territori i Shqipërisë së sotme dhe popullsia e tij ishin nga të parët që “u mësynë” nga misionarët e Krishtit. Kur në vitin 313 perandori Konstandin do ta deklaronte krishterimin si besimin fetar të perandorisë romake, ky deklaram do të vlente edhe për territorin pararendës të Shqipërisë së sotme dhe për popullsinë e saj.

Konfliktet dhe lufta e gjatë mes Romës dhe Bizantit, sollën në mesin e shekullit të 11-të edhe ndarjen e kishës në dy pjesë: në katolicizmin perëndimor dhe në ortodoksinë lindore. Shqipëria e atëhershme qëlloi të ishte pikërisht në vijëndarjen mes dy kishave dhe si rrjedhojë një pjesë e vendit, kryesisht ajo veriore mbeti

³ Merdani, Arlinda, *Marrëdhëniet ndërfetare në Shqipëri*, faqe 33, Onufri, Tiranë, 2014

nën ndikimin e Venedikut dhe vijoi të ushtrojë besimin e krishterë katolik, kurse pjesa qendrore dhe ajo jugore mbeti nën ndikimin e Bizantit duke ushtruar besimin e krishterë ortodoks. Edhe sot e kësaj dite feja katolike dhe ajo ortodokse janë pjesë e konfiguracionit fetar të pranishëm në Shqipëri dhe në territoret e banuara nga shqiptarët.

Pushtimi i Shqipërisë nga otomanët në shekullin e 15-të solli rrjedhoja të konsiderueshme edhe në ndryshimin e strukturës fetare të vendit. Me kalimin e kohës, gjatë pushtimit pesëshekullor otoman, rreth dy të tretat e popullsisë, u detyrua apo zgjodhi për arsye nga më të ndryshmet që të konvertohej në fenë islame të sjellë në vend nga otomanët. Studjuesit dhe historianët paraqesin faktorë të ndryshëm që ndikuan në këtë konvertim masiv.

Historiani shqiptaro-amerikan Stavro Skendi sheh si shkaqe të konvertimit: “dëshirën për të shmangur pagesën e taksave, joshjen prej avantazheve edhe për shkak se në themel të Perandorisë Otomane ishte feja dhe jo kombësia, si dhe mungesën e klerikëve për të plotësuar nevojat spirituale të popullsisë”.⁴

Lidhur me këtë temë, Roberto Moroco dela Roka, shkruan: “Islamizimi i Shqipërisë mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Pa dyshim, bëhej fjalë për

⁴ Skendi, Stavro, *Crypto-Christianity in the Balkans under the Ottomans*, Slavic Review 26, nr. 2, faqe 227-246, Qershor 1967

pranimin nga jashtë të një feje që sillte si pasojë adoptimin e një mënyre jetese të huaj për vendin. Por njëkohësisht, pranimi i islamit u lejonte shqiptarëve që të mbronin identitetin e vet etnik, me një veprim të suksesshëm prej kameleoni.”⁵

Gjithsesi, në fillim të shekullit të 20-të, kur vendi u çlirua nga otomanët dhe shpalli pavarësinë, Shqipëria rezultonte të ishte i vetmi vend në Europë me shumicën e popullsisë myslimane. Nga ana tjetër duhet thënë se pavarësisht nga konvertimi fetar, popullsia shqiptare myslimane, ashtu si edhe gjithë pjesa tjetër e popullsisë, ia doli të ruajë me përparësi identitetin dhe vetëdijen etnike dhe atë europiane.

Feja islame e aplikuar në Shqipëri është kryesisht e besimit sunit. Por një pjesë e popullsisë myslimane i përkasin drejtimit bektashi. Pas ndalimit të urdhrave bektashianë në Turqi në vitin 1925, kongresi i tretë i bektashinjve vendosi që të transferojë qendrën e vet në Shqipëri, duke u bërë kështu qendra botërore e bektashizmit.⁶

Krahas katër feve kryesore, përkatësisht fesë islame, ortodokse, katolike dhe bektashiane, në vend ndiqen në një masë më të vogël edhe disa drejtime të tjera fetare, si, protestanizmi, feja Bahai, Dëshmitarët e Jehovahit,

⁵ Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, faqe 21, Shtëpia botuese Elena Gjika, Tiranë

⁶ Po aty, faqe 34

Kisha e Jezu Krishtit dhe e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, etj.

Karakteristike për Shqipërinë ka qenë edhe prania për një kohë të gjatë e kriptokristianizmit. Gjatë pushtimit otoman, një pjesë e popullsisë mbante identitet të dyfishtë fetar: formalisht paraqitej si e besimit islam, kurse në familje ruante dhe aplikonte traditën dhe ritet e fesë së krishterë.⁷ Në disa zona të vendit, siç është përshembull, zona e Shpatit, banorët deri vonë kanë mbajtur dy emra: një mysliman dhe një të krishterë.

Përsa i takon shifrave apo raporteve të përbërjes fetare, në Shqipëri ende nuk ekzistojnë të dhëna shkencërisht të verifikuara. Studjuesit shpesh përmendin gjetjet e censusit të vitit 1938, sipas të cilit rezultonte se 70 përqind e popullsisë i përkiste besimit mysliman (sunit dhe bektashi), 20 përqind i përkiste besimit ortodoks dhe 10 përqind besimit katolik.⁸ Këto shifra mund të thuhet se janë pranuar deri vonë pa ndonjë lloj kontestimi.

Një census më i afërt i zhvilluar në vitin 2011, krahas regjistrimit të popullsisë përfshiu edhe pyetjen për përkatësinë fetare. Sipas këtij censusi, në popullsinë banuese të Shqipërisë, 56.7 % deklarohet me përkatësi

⁷ Skendi, Stavro, *Crypto-Christianity in the Balkans under the Ottomans*, Slavic Review 26, nr. 2, faqe 227-246, Qershor 1967

⁸ Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

fetare myslimane, 10,03 % deklarohej katolike, 6.75 % ortodokse dhe 2.09 % bektashiane. Por ky ishte një census i kontestuar nga pothuaj të gjitha komunitetet fetare si dhe nga mjedisi akademik për mungesën e seriozitetit dhe të parametrave shkencore. Sipas këtij censusi një përqindje e madhe e popullsisë preferoi të mos përgjigjej lidhur me përkatësinë fetare (13.79 %), kurse 5.49 % e konsiderojnë veten besimtarë por nuk duan ta identifikojnë këtë përkatësi.⁹

Gjithsesi, pavarësisht nga shifrat, historia dhe tradita fetare shqiptare karakterizohen në përgjithësi nga mungesa e konflikteve dhe e përplasjeve masive me bazë fetare, nga respekti i ndërsjelltë, pranimi dhe toleranca mes besimtarëve të besimeve të ndryshme si dhe nga mungesa e një qasjeje fundamentaliste ndaj fesë.

Një rol të madh në këtë mes ka luajtur ekzistenca e një forme tradicionale tolerante të Islamit të praktikuar nga shqiptarët. “Tradita Hanefi e Islamit sunit shqiptar ka qenë ngjizur me një frymë pranimi në vend të përjashtimit dhe me një mungesë apo zbehtësi të indikatorëve të supremacisë, anti-sekularizmit apo të totalitarizmit, që janë indikatorë të qartë të ekstremizmit fetar.”¹⁰

⁹ http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf

¹⁰ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 20, Tiranë 2016

Gjithashtu, nga studjuesit është vënë në dukje se historikisht ka ekzistuar edhe një prevalencë e identitetit kombëtar ndaj atij fetar. Në një qasje për të shpjeguar këtë prevalencë, studjuesi Artan Fuga shkruan: “Me anë të fesë ishte e pamundur që shqiptarët të unifikoreshin si grupim më vete. Mbetej gjuha si instrument i përbashkët njësues. Feja përfaqësonte një realitet të fragmentuar ndër shqiptarët, kurse gjuha, duke braktisur dialektet, përfaqësonte një element më të besueshëm dhe të kollajshëm për t’u konsideruar si kriter unifikimi.¹¹ Në të njëjtën linjë është edhe Miranda Vickers e cila thotë: “Historikisht shqiptarët janë i vetmi popull në Ballkan vetëdija nacionale e të cilëve nuk ka qenë e formësuar apo e identifikuar prej përkatësisë së tyre fetare. Në vend të kësaj shqiptarët e kanë definuar identitetin nacional të tyre përmes gjuhës.¹²” Edhe Roberto Moroco dela Roka e sheh nacionalizmin si identitet parësor i çdo shqiptari, pavarësisht nga besimi fetar.¹³

Në disa vende të Ballkanit feja (si e krishterë ashtu dhe myslimane) ka luajtur historikisht rol thelbësor në formësimin e identiteteve kombëtare dhe konsolidimin e disa prej shteteve të rajonit. Në Shqipëri, për shkak të

¹¹ Fuga, Artan, *Komunikimi në shoqërinë masive*, faqe 336, Papirus, Tiranë, 2014

¹² Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

¹³ Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, faqe 15, SHB Elena Gjika, Tiranë

përbërjes shumëfetare të shoqërisë, feja nuk pati rol kyç në ndërtimin e kombit dhe të shtetit. Që në ngjizjen e identitetit shqiptar, përplasjet fetare janë zëvendësuar nga harmonia dhe bashkëjetesa ndërfitare, duke mos u shndërruar asnjëherë në problem të sigurisë kombëtare. Besimi fetar nuk ka qenë komponent përcaktues i identitetit kombëtar. Historikisht feja në Shqipëri nuk ka shërbyer si ideologji organizuese e shtetit, kombit apo shoqërisë.¹⁴

Njohja dhe konsiderimi i traditës fetare shqiptare, merr një rëndësi të madhe sidomos po të kemi parasysh disa zhvillime që kanë ndodhur në Shqipëri pas rënies së komunizmit, në periudhën e cila njihet si periudha e tranzicionit.

¹⁴ Rakipi, A. *Lindja e një ndikimi të ri radikal në Shqipëri*. Gazeta Mapo. <http://www.mapo.al/2015/03/lindja-e-nje-ndikimi-te-ri-radikal-fetar-ne-shqiperi> (2015, 21 Mars)

2

Zhvillimet dhe problematika e viteve të tranzicionit

Pas një periudhe rreth 50-vjeçare të komunizmit, të aplikuar në një nga format e veta më të ashpra, në vitin 1991 Shqipëria hyri në rrugën e ndërtimit të një shoqërie liberal-demokratike të modelit të shoqërive perëndimore. Paralelisht me ndërtimin e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut, vendit iu desh që të rikuperojë edhe dëmet e pallogaritshme materiale dhe shpirtërore që diktatura i shkaktoi besimeve dhe institucioneve fetare.

Gjatë viteve të komunizmit, 2169 kisha, manastire dhe xhami u shkatërruan, u mbyllën apo u kthyen në muze apo në qendra për të rinj, salla sportive apo restorante.¹⁵ Pothuaj e gjithë infrastruktura e besimit fetar u asgjësua. Mungonin gjithashtu edhe klerikët, tekstet dhe e gjithë baza materiale. “Imagjinoni se në ç’gjendje ishte Shqipëria në vitet 90-të kur mungonin objektet e kultit për të kryer ritet. Në 1991 nuk kishim

¹⁵ Jung, Siegfried, *Skanderbegs Erben, Christen in Albanien*, Uhdingen: Stephanus Edition Verlag GmbH, 1990, Cit. në Merdani, Arlinda, *Marrëdhëniet ndërjetare në Shqipëri*, Onufri, Tiranë, 2014

kuadro në Shqipëri për të dërguar në çdo qytet për të drejtuar faljen e Bajramit. Kanë ardhur nga Kosova për herë të parë”¹⁶ -thotë në intervistën e tij teologu dhe ish-drejtuesi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Ermir Gjinishi.

Rindërtimi i institucioneve fetare dhe i objekteve të kultit kërkonte fonde të konsiderueshme, të cilat për momentin shoqëria dhe shteti shqiptar nuk i dispononte. Në mungesë të këtyre fondeve, në fillim të viteve ‘90, për ndërtimin e objekteve të kultit të fesë islame u paraqitën si një alternativë financimet nga disa fondacione që vinin nga vendet arabe dhe nga Turqia. Një lloj nxitjeje për këtë alternativë u bë edhe vendimi i Presidentit të Republikës i dhjetorit 1992 për të kërkuar anëtarësimin e Shqipërisë në Organizatën e Konferencës Islamike.

Pikërisht në këtë periudhë në Shqipëri nisën veprimtarinë e tyre rreth 20 fondacione të huaja arabe dhe islamike, prania dhe veprimtaria e të cilave ishte shumë intensive. Si pasojë e mungesës së burimeve financiare, Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH) u bë gjithnjë e më i varur nga fondet e fondacioneve të huaja. Intensiteti i veprimtarisë së këtyre aktorëve ishte i madh sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të parë të tranzicionit, kur kontrolli i shtetit ishte në nivele minimale.¹⁷

¹⁶ Intervistë me teologun Ermir Gjinishi. Intervistoi Laert Miraku

¹⁷ Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 40, AIIS, Tiranë, 2015

Krahas investimeve për ndërtimin e objekteve të kultit, këto fondacione bënë kujdes që brenda xhamive të reja të mësoheshin dhe të kryheshin rite të disa rrymave islame të panjohura për traditën shqiptare siç ishin salafizmi dhe vehabizmi, të cilat ndërkohë ishin të mirënjohura në botë për natyrën e tyre fundamentaliste të interpretimit të Islamit.

Në kuadër të politikës së përhapjes së rrymave së tyre fetare, fondacionet nga Lindja e Mesme kanë qenë mjaft aktive edhe në përgatitjen e brezit të ardhshëm të klerikëve, duke financuar studimin e tyre në universitete fetare të vendeve arabe. Kthimi i kësaj gjenerate studentësh shqiptarë të shkolluar në vendet arabe, ndryshoi natyrën e ndikimit të fondacioneve arabe. Studentët shqiptarë që dërgoheshin me studime jashtë nga fondacione të ndryshme islamike, përbënin shqetësim, pasi vendet dhe universitetet ku kanë studiuar ata konsiderohen burime të radikalizmit dhe ekstremizmit islamik.¹⁸

Ky grupim klerikësh që studjuan në shkollat arabe, me kthimin në Shqipëri krijoi një lloj ndarjeje edhe në komunitetin mysliman shqiptar. Lidhur me këtë situatë, Miranda Vickers shkruan: “Brenda Komunitetit Mysliman Sunit ekzistojnë dy grupe rivale: Fraksioni Selefi që përfaqëson një shkollë puritanike

¹⁸ Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 40, AIIS, Tiranë, 2015

antimoderniste dhe që promovon një interpretim strikt tradicional të doktrinës së Islamit dhe shkolla Hanefi që është për një interpretim tradicional liberal të Islamit. Gjatë viteve të fundit ka lindur një konflikt mes mbështetësve të shkollës Hanefi, të cilët janë në një moshë më të madhe dhe më të rinjve që janë kthyer nga një shkollim fetar i kryer në mjedise radikale islamike dhe që mbështesin shkollën Selefi të Islamit, e cila është më shumë radikale dhe shumë më pak tolerante.”¹⁹ Kjo situatë pranohet edhe nga aktivistë të njohur të fesë islame. Pyetjes a ka përçarje mes vetë myslimanëve në Shqipëri, njëri prej këtyre aktivistëve, në një intervistë të tijën në media i përgjigjet: “Përçarje ka. Ka besimtarë hanefi dhe vehabij, ka synitë dhe sufistë. Ndarjet vijnë më shumë si pasojë e shteteve të ndryshme që financojnë Islamin në vendin tonë.”²⁰ Ka patur raste që grupimi i radikalëve ka krijuar konflikte lokale edhe me besimet e tjera. Në intervistën e tij të realizuar në kuadër të këtij studimi, kreu i fesë bektashiane Edmond Brahimaj pohon: “Kemi pasur dy raste në vitet 2000 – 2001 në Bulqizë dhe Bllacë ku ekstremistë vehabistë, që ishin përqendruar tek xhamia e Bulqizës, dhunuan

¹⁹ Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

²⁰ Link: <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-u-krijua-nga-perandoria-osmane-myslimanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

objekte të kultit bektashian në Bulqizë dhe në teqenë e Bllacës, duke na sjellë shqetësime tek besimtarët tanë, deri dhe në konflikte. Por me urtësi dhe dashamirësi, në bashkëpunim me komunitetin mysliman, u parandaluan këto veprime ekstremiste.”²¹ Mediat kanë raportuar gjithashtu edhe për një konflikt mes dy grupeve të komunitetit sunit në një fshat të Librazhdit.²²

Ishin pikërisht zhvillimet e mësipërme që shënuan për herë të parë në historinë e Shqipërisë jo vetëm futjen e disa shkollave të reja radikale të mësimin të fesë Islame, të cilat ishin larg nga tradita Hanefi e Islamit shqiptar, por edhe krijimin e bazave për lindjen e radikalizmit dhe ekstremizmit islamist në vend. “Fillimisht shqetësimi për zhvillimet në komunitetin e myslimanëve sunitë - i shfaqur edhe në media - ka qenë i lidhur me ligjërimin radikal në disa xhami të vendit dhe predikimin në to të shkollave fetare që ofronin një interpretim të huaj intolerant të Islamit. Por zbulimi nga ana e organeve të sigurisë në fund të viteve 90-të i lidhjeve apo financimit të një pjese të fondacioneve të huaja islamike prej organizatave terroriste hodhi dritë mbi një anë tjetër të errët dhe të panjohur të problemit: atë të asociimit

²¹ Intervistë me Edmond Brahimaj, kreu i komunitetit bektashian. Intervistoi Laert Miraku

²² *Imamë e hoxhallarë të Librazhdit: të ikë myftiu Taulant Bica, po përçan besimtarët*, Link: <http://www.balkanweb.com/site/imame-e-hoxhallare-te-librazhdit-te-ike-myftiu-taulant-bica-po-percan-besimtare/>

të aktivitetit fetar jo thjesht me radikalizmin. por edhe me ekstremizmin e dhunshëm islamist. Më tej, lufta e ISIS në Siri dhe Irak ri-nxori në sipërfaqe praninë e këtij ekstremizmi në vend si dhe zbuloi edhe ekzistencën e mercenarizmit fetar islamist.”²³

Në më shumë se një herë, mediat kanë sensibilizuar opinionin për ekzistencën e një numri të konsiderueshëm të xhamive që janë jashtë kontrollit të KMSH. Raportimet e mediave u konfirmuan edhe prej raporteve të organeve të sigurisë. Kështu në fillim të dhjetorit 2015, Shërbimi Informativ Shtetëror do të deklaronte se janë 89 xhami që janë jashtë këtij kontrolli, ndërkohë që vetë KMSH deklaronte se ishin vetëm 9 të tilla.²⁴ Problemi i xhamive të paligjshme u përfshi në agjendën e diskutimit publik sidomos pas arrestimit në mars 2014 të nëntë personave, mes tyre edhe imamët e dy prej xhamive të Tiranës që ishin jashtë kontrollit të KMSH, të cilët akuzoheshin për ngritjen e një skeme rekrutimi të shqiptarëve që dërgoheshin për të luftuar në Siri.

Një ngjarje tjetër e bujshme ishte edhe ajo vitit 2016, të cilën e kemi përmendur edhe më sipër, ku u arrestua një grup që kishte planifikuar dhunë terroriste gjatë ndeshjes së futbollit Shqipëri-Izrael në nëntor 2016. Kjo ngjarje si dhe arrestimi i imamëve të Tiranës provoi

²³ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 25, Tiranë 2016

²⁴ *Gazeta Panorama*, datë 26 nëntor 2015, faqe 2

se, nëse deri në vitin 2000 ekstremizmi i dhunshëm islamist në Shqipëri identifikohet kryesisht tek individë apo organizata të huaja, tashmë ai identifikohet edhe tek individë apo struktura religjioze vendase. Pra, fenomeni nuk është më vetëm një fenomen i importuar nga të huajt në Shqipëri, por tashmë ai është edhe një fenomen dhe produkt vendor. Dhe paraqitet në format e veta më ekstreme. Në të dyja rastet, mediat, bazuar në deklaratimet e policisë dhe të prokurorisë, flasin për prani dhe zbulim të “celulave terroriste” dhe për lidhje me krimin e organizuar.²⁵

Nga kërkimi i kryer në kuadër të këtij studimi është verifikuar gjithashtu edhe prania e një diskursi intensiv islamist që zhvillohet në hapësirën online në gjuhën shqipe, ku vihet re një numër i madh websajtesh që promovojnë gjithfarë shkollash të huaja të interpretimit të Islamit, që nga ato më të moderuarat deri tek ato të ekstremit të skajshëm. Kjo të krijon përshtypjen se përveç mercenarizmit të armës, po zhvillohet edhe mercenarizmi i fjalës. Shuma të konsiderueshme shpenzohen për mbajtjen e qindra websajteve dhe gjithashtu me qindra vetë paguhen për të shkruar dhe sidomos për të përkthyer në shqip si dhe për të përhapur ndër shqiptarët shkolla dhe doktrina fetare që janë larg traditës Hanefi.²⁶

²⁵ *Lufta në Siri, zbulohet celula terroriste në Tiranë*, 14.03.2014, Link: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=42332>

²⁶ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 26, Tiranë 2016

Përveç formave të ekstremizmit islamist, në raste tepër të izoluara është verifikuar edhe prania e dy formave të tjera të ekstremizmit: ekstremizmit anti-Islam dhe ekstremizmit ateist. Por të dyja këto forma nuk kanë lidhje me aktivitetin apo ligjërimin e institucioneve fetare dhe nuk vihet re ndonjë shenjë e lëvizjeve të organizuara. Ekstremizmi anti-Islam paraqitet kryesisht si një ndikim i ideologjive politike të ekstremit të djathtë, të cilat kanë një terren absolutisht minimal dhe gati inekzistent në vend. Kurse ekstremizmi ateist paraqitet si një ndikim i ideologjive politike të ekstremizmit të majtë, kryesisht si reminishencë e mbetjeve ideore apo e trashëgimisë nga e kaluara e afërt komuniste e vendit.²⁷

Ndërkohë mund të thuhet se ndaj ekstremizmit fetar nuk është e ekspozuar vetëm feja Islame. Andon Merdani i kishës ortodokse thotë në një intervistë për këtë studim se “nga tendencat fondamentaliste nuk mund të përjashtohet asnjë grupim fetar. Ajo që është më shqetësuese është fakti kur këto tendenca bëhen të dukshme dhe të shpeshta dhe nuk ballafaqohen siç duhet nga secili grupim fetar respektiv.”

Lind pyetja: Në ç’shkallë është përhapja e radikalizmit dhe e ekstremizmit fetar në vend? Disa studime që janë ndërmarrë në Shqipëri si përshembull

²⁷ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 26, Tiranë 2016

studimi “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM, 2015) apo studimi tjetër “Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri” (AIIS, 2015) e vlerësojnë situatën si “një dukuri në fazë të hershme”, “embrionale”²⁸ ose si një “zhvillim në fazë fillestare”²⁹. Por njëherësh këto studime i shohin zhvillimet si një kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, që përmban edhe rrezikun e cënimit të harmonisë fetare, çka do të ishte fatale për sigurinë, stabilitetin, madje edhe për të ardhmen e vendit.³⁰

²⁸ *Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*, IDM, 2015, f. 34

²⁹ *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 4, AIIS, 2015

³⁰ *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 4, AIIS, 2015

3

Kanalet e komunikimit fetar dhe media në Shqipëri

Kanalet kryesore të komunikimit të informacionit që lidhet me fenë në Shqipëri janë mediat tradicionale dhe mediat online. Këtu përfshihen edhe mediat e vetë komuniteteve fetare apo të organizatave dhe individëve të përfshirë në komunikimin fetar. Sakaq, një kanal i rëndësishëm komunikimi mbetet edhe ligjërimi brenda objekteve të kultit si dhe komunikimi ndërpersonal. Ky i fundit konsiderohet i aplikueshëm me përparësi në rastet e shkëmbimeve komunikative me natyrë fundamentaliste dhe ekstremiste. Por janë verifikuar raste të propogandës ekstremiste edhe në ligjërimin e kryer në disa objekte kulturi të fesë Islame që kanë qenë jashtë kontrollit të KMSH.

3.1. Mediat e komuniteteve fetare

Gjatë periudhës së komunizmit, bashkë me institucionet dhe objektet e kultit, u mbyllën edhe mediat e komuniteteve fetare. Në këtë situatë, pas rënies së

sistemit komunist, një nga përparësitë e komuniteteve fetare ishte edhe rihapja apo themelimi i mediave dhe i kanaleve të tjera të komunikimit.

Mediat e komuniteteve fetare kanë një traditë relativisht të hershme në Shqipëri. Kështu revista “Zani i Naltë” është hapur qysh në vitin 1923, në kohën kur u themelua edhe Komuniteti Mysliman Shqiptar. Pas mbylljes në periudhën e diktaturës, ajo u rihap sërish në vitin 1991. KMSH boton gjithashtu edhe revistën Drita Islame, një tjetër medium, i cili, siç thotë në intervistën e tij Bujar Spahiu, nënkryetar i KMSH, “ka synim ndriçimin e mendjes dhe zemrës së njeriut me dituri të dobishme për një person i cili ka arsye të shëndoshë të njohë dhe kuptojë fenë e tij”. “Në të dy këto revista -vijon Spahiu - ka shkrime të ndryshme jo vetëm fetare por edhe shkrime sociale, psikologjike nga autorë të ndryshëm që shprehin mendimet dhe komentet e tyre. Ata që shkruajnë në këto revista nuk janë vetëm anëtarë të komunitetit, por edhe njerëz të tjerë specialistë dhe profesionistë të fushave të tyre, njerëz të ndritur në mendje.”³¹

Gjithashtu KMSH ka websajtin e vet institucional në adresën www.kmsh.al i cili përditësohet rregullisht me lajmet nga veprimtaritë e komunitetit si dhe me

³¹ Intervistë me Bujar Spahiun, Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Intervistoi Laert Miraku

informacione të tjera. Ndërkohë Komuniteti nuk ka kanal televizioni apo radioje të vetin.

Krahas këtyre mediave, në hapësirën shqipfolëse ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm mediash të tjera të komunikimit fetar islam, sidomos në mjedisin online. Në mesin e mediave online të lokalizuara në Shqipëri, një influencë të madhe si dhe një numër të madh ndjekësish kanë dy websajte, përkatësisht observer.al dhe e-zani.com.

Observer.al është faqja e Observatorit Kombëtar kundër Islamofobisë. Siç thuhet edhe në përshkrimin e këtij websajti, Observatori “është një iniciativë vullnetare e disa intelektualëve, të cilët, të nxitur nga problemet me të cilat përballet shoqëria jonë në përgjithësi dhe muslimanët në veçanti, e kanë parë të nevojshme hapjen e një platforme online ku të trajtohet me profesionalizëm problemi i Islamofobisë, racizmit dhe gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit Musliman Shqiptar e më gjerë. Qëllimi: Të luftojmë islamofobinë me anë të një platforme online si dhe të krijojmë një bazë të dhënash me rastet e islamofobisë. Gjithashtu, Observatori Kombëtar Kundër Islamofobisë ka për qëllim raportimin e islamofobisë në Ballkan (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni) si dhe ofrimin e analizave në përgjigje të këtyre zhvillimeve.”

Portali tjetër, e-zani.com botohet nga Aksioni Civil Mysliman, një organizatë jo-fitimprurëse e lokalizuar në Tiranë. Në të gjen lajme nga veprimtaritë e komunitetit

musliman si dhe artikuj me tematika të ndryshme fetare, një pjesë e të cilave kanë hapur edhe debat apo ka qenë objekt i një diskutimi më të gjerë publik.

Krahas mediave të komunitetit apo të organizatave të njohura në vend, në mjedisin online në gjuhën shqipe gjallojnë edhe një numër relativisht i madh websajtesh që rezultojnë të jenë krijuar dhe të mbahen nga organizata fetare islamike të lokalizuara në Turqi apo në vendet e Lindjes së Mesme. Një pjesë e këtyre websajteve promovojnë shkolla apo rryma fetare islame që nuk përputhen me traditën e Islamit shqiptar dhe që janë më radikale në interpretimin e doktrinës islamike. Veçanërisht problematike janë ato faqe që promovojnë në gjuhën shqipe dhe në mjedisin shqipfolës rrymat e salafizimit dhe të vehabizmit si dhe rryma apo sekte të tjera të ekstremitetit të skajshëm. Për promovimin e salafizimit ka edhe një websajt të posaçëm në gjuhën shqipe në adresën www.selefi.org, i cili vetëquhet “faqja e selefijve shqiptarë”.

Përsa i takon komunitetit ortodoks, llojet e mediave që ai boton janë të larmishme. Me qendër në Tiranë operon kanali i radios “Ngjallja” si dhe botohet gazeta e përmuajshme me të njëjtin emër. Krahas këtyre, Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare boton edhe revistën shkencore “Kërkim”, revistën rinore “Kambanat” si dhe revistën për fëmijë “Gëzohu”.

Komuniteti ortodoks ka edhe websajtin e vet institucional që gjendet në adresën www.ortodoksi.org.

orthodoxalbania.org.³² Si kanale të efektshme komunikimi për këtë komunitet kanë shërbyer edhe predikimet dhe mësimet në objektet e kultit ose në ambientet që komuniteti disponon apo shfrytëzon, në kampingje dhe aktivitete të ndryshme, etj.³³

Edhe komuniteti katolik ka kanalet e veta të komunikimit masiv. Por, siç ka theksuar edhe Imzot George Frendo në një intervistë të realizuar nga Instituti i Medias, “kanali kryesor është kremtimi liturgjik, veçanërisht në meshë çdo ditë të diel. Përveç kësaj, secila nga 6 dioqezat në Shqipëri ka gazetën e vet si dhe websajtin e vet institucional. Komuniteti ka edhe një kanal radioje: Radio Maria.” Por Imzot George Frendo insiton se më e efektshme për komunikimin publik është pa dyshim mesha e së dielës.³⁴

Ndërsa lidhur me kanalet e komunikimit që disponon dhe përdor komuniteti bektashi, kreu i këtij komuniteti, Edmond Brahimaj thotë: “Kanalet e komunikimit të Komunitetit botëror të Bektashinjve me publikun janë të gjera. Ne kemi institucionet bektashiane ne Shqipëri e në vende të botës, që janë kthyer në qendra të mëdha pelegrinazhi, qetësie shpirtërore e besimi për miliona

³² Këto informacione janë ofruar për këtë studim nga Nikolin Zharkalliu, punonjës në administratën e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare

³³ Intervistë me Andon Merdani, përfaqësues i Kishës Ortodokse, Intervistoi Laert Miraku

³⁴ Intervistë me Imzot George Frendo. Intervistoi Laert Miraku

njerëz. Faljet e tyre dhe bekimi i klerikëve i afron ata më shumë me Krijuesin, i bëjnë më të devotshëm për veten, shoqërinë e familjen. Po ashtu, ne kemi median tonë për të komunikuar me besimtarët e me publikun, jemi të pranishëm sistematikisht në median e shkruar dhe vizive e elektronike. Po ashtu, ne kemi ndërtuar Odeonin, unikal në botë në llojin e vet, ku ndodhet një bibliotekë shumë e pasur, ndodhet arkivi tetë shekullor i bektashinjve, salla e shtypit, një muze i pasur dhe mjedise të tjera social-kulturore.”³⁵

Në një karakterizim të përgjithshëm mund të thuhet se mediat dhe kanalet institucionale të komunikimit masiv të komuniteteve fetare kanë qenë korrekte në kryerjen e misionit të tyre religjioz dhe kanë ndërtuar e përcjellë një komunikim i cili ka mbartur frymën e respektit të ndërsjelltë mes besimtarëve, tolerancën dhe harmoninë që kanë mbizotëruar në traditën fetare shqiptare.

3.2. Raportimi për fenë në mediat shqiptare

Nga monitorimi i kryer në kuadër të këtij studimi rezulton se mediat kryesore në Shqipëri, qofshin ato të printuara, televizive apo radiofonike, raportojnë për

³⁵ Intervistë me kreun e fesë bektashiane, Edmon Brahimaj. Intervistoi Laert Miraku

fenë dhe zhvillimet që lidhen me të, kryesisht në këto raste:

1. Në rastet e festave të shënuara fetare
2. Në rastet e konflikteve apo përplasjeve me natyrë fetare
3. Në rastet e deklaratave kontraversale në lidhje me fenë, historinë e saj dhe marrëdhëniet ndërfitare në Shqipëri
4. Në rastet e skandaleve brenda komuniteteve fetare

Përsa i takon zhanreve të përdorura, krahas lajmeve, një vend të veçantë në axhendën e mediave zënë edhe komentet dhe analizat në gazeta, televizion, radio si dhe në median online për tema dhe këndvështrime të debatueshme. Gjithashtu, në një numër më të kufizuar, në media janë botuar apo transmetuar edhe intervista, reportazhe, apo profile nga kjo fushë.

Raportimi i mediave kryesore për ceremonitë dhe aktivitetet që organizohen me rastin e festave të shënuara fetare, rezulton të jetë përgjithësisht korrekt dhe i balancuar për të gjitha fetë kryesore në vend. Këtë e konfirmojnë edhe drejtuesit e fesë: “Kursesi nuk mund të flasim për diferenca që mediat tradicionale të kenë mbajtur për një komunitet të caktuar fetar. Me legjislacionin shqiptar festat fetare janë të detyruara të transmetohen nga televizioni publik”.³⁶

³⁶ Intervistë me Bujar Spahiun, Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Intervistoi Laert Miraku

Por në një mënyrë stereotipike, pothuaj të gjitha mediat kryesore, i kushtojnë një vëmendje të madhe pjesëmarrjes dhe deklaratave në këto ceremoni të drejtuesve kryesorë të politikës dhe të shtetit, duke i intervistuar rregullisht ata në momentet që dalin nga ceremonitë. Kamerat apo mikrofonët e gazetarëve, në vend që të drejtohen në këto ditë nga besimtarët dhe klerikët, vijnë që me forcën e zakonit të mediave të politizuara deri në palcë të drejtohen nga politikanët. “Një fenomen i rëndomtë që vihet re në raportimin e mediave të aktiviteteve me bazë ose sfond fetar është se përqendrohen vetëm në vlerësimet dhe komentet e politikanëve dhe të qeveritarëve, duke shmangur në jo pak raste tërësisht fetarët dhe mendimin e tyre.”³⁷ – thotë përfaqësuesi i fesë ortodokse, Andon Merdani.

Në rastet e konflikteve apo përplasjeve me natyrë fetare, të cilat duhet thënë se në Shqipëri janë të rralla, në përmasa të vogla dhe tepër të lokalizuara, raportimi i mediave ka qenë përgjithësisht i paanshëm dhe neutral. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në rastet e deklaratave kontraversale në lidhje me fenë, historinë dhe marrëdhëniet ndërfitare në Shqipëri. Herë pas herë në mediat kryesore janë raportuar raste kur individë radikalë, fondamentalistë apo ekstremistë, qofshin këta përfaqësues të klerit apo persona të tjerë publikë,

³⁷ Intervistë me Andon Merdani, përfaqësues i Kishës Ortodokse, Intervistoi: Laert Miraku

bëjnë në mjedise publike apo në media deklarata kontraversale, si përshembull ato që lidhen me figurën e heroit kombëtar, Skënderbeut apo me figurën e Nënë Terezës, deklaratat për prejardhjen fetare të shqiptarëve, etj. Gjithsesi duhet thënë se diskursi radikalist më së shumti është i denoncuar nga mediat dhe jo i promovuar prej tyre.

Sjellja e deklaratave dhe e qëndrimeve radikaliste në media mund të shihet nga dy këndvështrime: Nga njera anë, prania në axhendë dhe hapja e medias ndaj personazheve ekstremistë, si në rastin e disa intervistave në gazeta e kanale televizive, mund të bëhet bazë për mbjelljen apo amplifikimin e tezave ekstremiste, por nga ana tjetër ato krijojnë terrenin që të hapet një debat publik rreth këtyre qëndrimeve, duke ndihmuar masën e gjerë të njerëzve, një pjesë e të cilëve mund të jenë të ekspozuar ndaj tyre që të krijojnë një mendim më të qartë dhe të mbajnë një qëndrim më të informuar.

Një problem i ngritur jo rrallë prej studiuesve, por edhe prej përfaqësuesve të klerit, është cektësia apo mungesa e profesionalizmit në rastin e raportimeve për fenë “Në mediat kryesore ende nuk ka gazetarë të specializuar për të raportuar mbi çështjet fetare; niveli i njohurive mbi besimet dhe praktikat fetare është jo rrallë në kufijtë e injorancës e të keqkuptimit”³⁸ – thotë

³⁸ Fico, Delina, *Dialogu dhe bashkëpunimi ndërjetar në shërbim të harmonisë fetare në Shqipëri*, Në: “Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri”, faqe 45-46, Tiranë 2010

studiuesja dhe aktivistja e shoqërisë civile Delina Fico. Diçka e tillë konfirmohet edhe nga përfaqësuesit e fesë: “Vihet re mungesa e njohurive dhe e terminologjisë fetare nga ana e gazetarëve”, thotë Andon Merdani i fesë ortodokse.

Në këtë kontekst, nënkryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bujar Spahiu i këshillon gazetarët, të cilët sipas tij kanë një profesion të vështirë dhe të nderuar: “Përpara së të shkruajnë dhe të publikojnë diçka për problemet fetare duhet ta konsultojnë më parë me specialistë apo klerikë të fesë. Sepse një term i mos kuptuar mirë dhe i thënë gabim mund të lëndojë shumë zemra dhe mendje. Transmetimi i një lajmi të drejtë dhe të saktë ua rrit vlerat gazetarëve.”³⁹

Një diskutim është hapur në mjediset akademike dhe ato fetare edhe lidhur me prioritetet e axhendës së mediave që lidhet me fenë. Ka zëra që theksojnë se mediat raportojnë për fenë “kryesisht kur shfaqet një konflikt real ose i perceptuar, dhe gazetarët “gjëmojnë” skandalin”.⁴⁰ Lidhur me këtë Imzot George Frendo thotë: “Cilat janë kriteret që përdorin mjetet e komunikimit për të vlerësuar lajmet që duan t’i komunikojnë popullit? Cilat lajme konsiderohen si lajme më interesante për

³⁹ Intervistë me Bujar Spahiun, Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Intervistoi Laert Miraku

⁴⁰ Fico, Delina, *Dialogu dhe bashkëpunimi ndërfaqetar në shërbim të harmonisë fetare në Shqipëri*, Në: “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, faqe 45-46, Tiranë 2010

publikun e mjeteve të komunikimit? Së pari, lajmet polemike, konfliktuale. Së dyti, lajmet për njerëzit të njohur. Së treti, lajmet skandaloze, që shkaktojnë habi dhe zemërim në njerëzit. Kur për shumë muaj mjetet kanë folur për priftërinjtë pedofilë, ky lajm u dha me aq shumë publicitet pikërisht sepse ishte një lajm skandaloz. Por nuk flasin për shumë priftërinj që me shumë sakrificë angazhohen për të mirën e popullit.”

Kjo reflekton sipas tij “hipokrizinë e shoqërisë së sotme që skandalizohet nga çdo mëkat i madh ose i vogël i një prifti dhe nuk skandalizohet për shembull nga milionat e viktimave të pafajshëm të prindërve të divorcuar, ose të aborteve. Ndonjëherë kjo shoqëri e sheh lëmishten në syrin tonë por nuk e sheh traun në syrin e vet.”⁴¹

Në lidhje me aspektin edukues të medias, nga intervistat dhe nga monitorimi verifikohet se mediat kryesore nuk kanë ndonjë axhendë specifike për këtë qëllim. Kjo reflektohet edhe në faktin që nuk ekziston ndonjë rubrikë e veçantë apo ndonjë emision i dedikuar posaçërisht për informacionin dhe problemet që lidhen me fenë. Gjithsesi në disa *talk show*, si “Opinion” i TV Klan, “Top Story” dhe “Top Show” të kanalit televiziv Top Channel dhe në disa programe të tjera me format të ngjashëm në televizionet lokale, janë organizuar debate që lidhen me fenë, të cilat kanë ndihmuar në informimin

⁴¹ Intervistë me Imzot George Frendo. Intervistoi Laert Miraku

dhe qartësimin e publikut për zhvillime dhe çështje të debatueshme si dhe kanë nxitur edhe një debat të gjerë publik për to.

Përsa i takon investigimit të mediave lidhur me ekstremizmin fetar në vend, rezulton se ai është i varfër, i pamjaftueshëm dhe shumë sporadik. Përveç ndonjë rasti të rrallë, siç ishte ai i një investigimi të kryer nga gazetarët e rrjetit BIRN në lidhje me veprimtarinë rekrutuese në shërbim të ISIS⁴² (*Shqipëria përballet me rrezikun e "luftëtarëve xhihadistë në hije"*, Investigim i kryer nga Aleksandra Bogdani e rrjetit BIRN, Shih linkun në footnotes) dhe disa përpjekjeve të tjera investigative me rëndësi më të vogël, duhet thënë se mediat nuk janë angazhuar sa dhe si duhet në këtë drejtim.

Dy nga pyetjet kërkimore në kuadër të këtij studimi kanë qenë: Nga pikëpamja sasiore, sa i pranishëm është diskursi eskremist fetar në median shqiptare? Dhe nga pikëpamja cilësore, cilat janë termat kryesorë përmes të cilëve ai shfaqet?

Një monitorim i kryer nga Instituti Shqiptar i Medias në vitin 2015 që përfshiu shtypin dhe mjedisin online në gjuhën shqipe sjell të dhëna që japin një përgjigje në plan sasior.

⁴² *Shqipëria përballet me rrezikun e "luftëtarëve xhihadistë në hije"*, Investigimi i kryer nga Aleksandra Bogdani e rrjetit BIRN. Link: <https://www.reporter.al/shqiperia-perballet-me-rrezikun-e-luftetareve-xhihadiste-ne-hije/>

Kështu nga monitorimi u identifikuan një numër prej 284 materialesh, duke nisur nga materialet e moderuara deri tek materialet ekstreme. Një numër prej 201 materialesh u identifikuan në median online, kurse 83 u identifikuan në shtyp. Për klasifikimin e këtyre materialeve është përdorur si mekanizëm Indeksi i Mediave Ekstremiste i propozuar nga Donald Holbrook⁴³, i cili dallon tre kategori të informacionit me natyrë ekstremiste: 1. E moderuar, 2. Në zgrip dhe 3. Ekstreme.

Materialet që kanë përmbajtje të kategorisë “E moderuar”, sipas Holbrook janë materiale dhe komente të përgjithshme fetare, politike, filozofike dhe historike që nuk ofrojnë qasje aprovuese ndaj dhunës apo urrejtje ndaj komuniteteve të identifikuara, me një përmbajtje përgjithësisht të moderuar deri në fund dhe që gjendet në tekstet fetare/politike si dhe në produktet e mediave të lajmit.

Në kategorinë e materialeve “Në zgrip” hyjnë ato materiale, në të cilat, sipas Holbrook, përmbajtja, nga pikëpamja fetare apo ideologjike është konservatore dhe izolacioniste, politikisht radikale dhe konfrontuese, por që nuk përcjell justifikime për dhunën në skenaret aktuale. Në materiale të tilla mund të ketë edhe shprehje të zemërimit apo të armiqësisë

⁴³ Shih: Holbrook, Donald, *Designing and Applying an “Extremist Media Index”*, Perspectives on Terrorism Volume 9, Issue 5, 2015

ndaj një grupi të caktuar njerëzish, por pa arritur deri në përfundimin se ata janë qenie nën-humane dhe objektiv i logjikshëm i dhunës.

Kurse në kategorinë “Ekstreme” përfshihen materialet që përmbajnë miratim dhe glorifikim të dhunës në kontekste bashkëkohore dhe dehumanizim të tjetrit.

Nga 284 materiale të gjetura, 194 janë të kategorisë “E moderur”, 82 janë të kategorisë “Në zgrip”, dhe vetëm 8 janë të kategorisë “Ekstreme”. Këto të fundit janë verifikuar në mjedisin online dhe kanë patur si burim mediat sociale apo disa websajta fetare në gjuhën shqipe të krijuara nga ISIS apo nga organizata të ndryshme të Lindjes së Mesme.

Ato përfshijnë materiale të tilla, si përshebull, deklarata e një ekstremisti që justifikon ekzekutimin e tmerrshëm të pilotit të forcave ajrore jordaneze nga forcat e ISIS, shfaqja e simpatisë për terroristë të njohur shqiptarë në radhët e ISIS, thirrja për ndezjen e xhihadit në Rusi dhe vrasjen e ushtarëve rusë, videoja kërcënuese në gjuhën shqipe që kërcënon shqiptarët me vënie eksplozivësh, videoja tjetër që u bën thirrje shqiptarëve të Maqedonisë për të rrëmbyer armët për luftë të shenjtë, thirrja e një imami për të kaluar në Intifadën e tretë kundër hebrenjve dhe për vrasje me

thikë të tyre, shkrimi që promovon vrasjen si ndëshkim për homoseksualët, etj.⁴⁴

Duhet thënë se një pjesë e materialeve janë identifikuar në websajtet fetare dhe në faqet e mediave sociale, kryesisht në ato të fesë Islame, të cilat në gjuhën shqipe rezultojnë të jenë në një numër shumë të madh në raport me numrin e popullsisë dhe përmbajnë literaturë dhe qasje konservatore nga pothuaj të gjitha shkollat dhe rrymat fetare të Islamit që zhvillohen aktualisht në botë. Kjo tregon se, nëse në rastin e territorit fizik, vetëm një pjesë e vogël e tij është jashtë kontrollit të KMSH, në rastin e “territorit” virtual të fesë Islame shqiptare shumica absolute e saj është jashtë kontrollit apo vëmendjes së KMSH.⁴⁵

Po nga pikëpamja e kërkimit cilësor, cilat janë termat kryesorë të diskursit ekstremist në mediat shqiptare? Më poshtë po paraqesim linjat kryesore të këtij diskursi, të identifikuara përmes analizës së përmbajtjes të kryer në kuadër të këtij studimi.

⁴⁴ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 41, Tiranë 2016

⁴⁵ *Po aty*

4

Linjat kryesore të diskursit ekstremist fetar në median shqiptare

Nga pikëpamja metodologjike, për të mundësuar një identifikim më të qartë të përmbajtjes me natyrë ekstremiste, ka qenë e nevojshme që të kemi një pikë referimi lidhur me atë që do të konsiderohet si “ekstreme”. Kjo pikë referimi e përdorur në këtë studim ka qenë pikërisht modeli kushtetues liberal-demokratik i shoqërive perëndimore. Ky model, që ka qenë një aspiratë e hershme e shqiptarëve, tashmë është në një proces adoptimi në Shqipëri dhe shihet nga shumica dërmuese si e vetmja perspektivë për vendin dhe shoqërinë. Brenda këtij modeli, bashkëjetojnë natyrshëm edhe disa vlera specifike të shoqërisë shqiptare, siç janë harmonia ndërfaqetare, prevalenca e identitetit kombëtar ndaj identiteteve të tjera, respektimi i traditës, etj., të cilat janë gjithashtu pika të rëndësishme referimi për identifikimin e ekstremeve dhe të ekstremizmit.

Bazuar në këtë qasje konceptuale dhe metodologjike, ky studim ka evidentuar edhe linjat kryesore të diskursit ekstremist fetar në mediat shqiptare.

“Më së pari jam mysliman, pastaj shqiptar”

Kjo deklaratë e bërë nga një prej përfaqësuesve të zellshëm të ekstremizmit fetar islamist në emisionin “Opinion” të TV Klan dhe e raportuar nga pothuaj të gjitha mediat kryesore shqiptare, shpreh në mënyrë tepër të qartë dhe të koncentruar një nga linjat kryesore të diskursit ekstremist fetar që e konsideron identitetin fetar si prioritar në raport me identitetin kombëtar dhe identitetet e tjera. Ky lloj diskursi është shfaqur në mënyrë të bujshme në mediat europiane në dhjetor të vitit 2001, kur ato botonin thënien e terroristit islamist Khaled Kelkal “Unë nuk jam as francez, as arab, jam mysliman”. Mbërritja dhe artikulimi në hapësirën multifetare shqiptare i këtij diskursi të promovuar nga eksponentët më famëkeq të terrorizmit ndërkombëtar, është një lajm vërtet shqetësues.

Cilat janë përmasat dhe përhapja e këtij lloj diskursi në Shqipëri? Para së gjithash duhet thënë se, nëse një dekadë më parë ky diskurs lokalizohej kryesisht në mjedise të mbyllura, në komunikimin ndërpersonal apo në *echo chambers* të mediave sociale, aktualisht ai po shfaqet në mënyrë të herë-pas-hershme edhe në komunikimin publik në mediat kryesore. Gjithashtu numri i atyre që e artikulojnë publikisht këtë diskurs si dhe i atyre që janë të ekspozuar ndaj tij vjen duke

u shtuar. Dhe po përpunohen e po sofistikohen më tej edhe argumentet dhe baza teorike.

Siç e kemi përmendur edhe më sipër, historikisht dhe tradicionalisht në Shqipëri, identiteti kombëtar ka prevaluar mbi të gjitha identitetet e tjera, pasi është konsideruar si një njësi unifikuese e shqiptarëve, pavarësisht nga feja e tyre. Strategjia e Rilindjes e bazuar në postulatit e Pashko Vasës “feja e shqiptarit është shqiptaria” është përkrahur masivisht nga shqiptarët dhe ka shërbyer e shërben si një aks qendror i paktit social dhe tipar modelor i ndërtimit dhe funksionimit të shoqërisë shqiptare. “Duke studjuar historinë fetare shqiptare dallohet kushtëzimi kulturor vendimtar i nacionalizmit në mendësinë e besimtarëve dhe të hierarkëve të çdo grupi a besimi fetar. Në bazë të besimit patriotik, shqiptarët e një feje tjetër shiheshin si vëllezër çdo herë që duhej përballuar bashkërisht një gjendje emergjence për kombin”, shkruan Roberto Moroco dela Roka.⁴⁶

Por në një linjë të kundërt, një autor që vjen nga bota akademike dhe që është i njohur për ligjërimin kontraversal, e konsideron postulatit “feja e shqiptarit është shqiptaria” si një slogan të palogjikshëm poetik. Sipas tij, “Po qe se nacionalizmi shqiptar do të ishte i fortë, agresiv dhe ekspansiv, slogani i tillë edhe do të mund

⁴⁶ Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, faqe 15, SHB Elena Gjika, Tiranë

të pranohej në funksion të ekspansionit nacionalist. Por, nacionalizmi shqiptar është tej mase i degraduar, i rrëgjuar dhe i paaftë që të prodhojë aktivizëm, në pajtim me parimet e nacionalizmit. Prandaj sloganet e tilla nuk përdoren për mobilizim kombëtar, sepse ai mobilizim nacionalist nuk ekziston fare, veçse përdoren për zbehjen e identitetit fetar të shumicës së shqiptarëve.”⁴⁷

Siç lexohet qartë mes rreshtave, shqetësimi i autorit nuk ka të bëjë realisht me nacionalizmin shqiptar, të cilin e denigron në termat më të rreptë të mundshëm, por me faktin se ai ka ndikuar në “zbehjen e identitetit fetar të shumicës së shqiptarëve”.

Në diskursin ekstremist, kundërvënia e identitetit fetar ndaj identitetit kombëtar, e cila bëhet me synim zhvlerësimin e këtij të fundit, shpesh paraqitet në terma konkretë, përmes kundërthëniesh që kërkojnë të vënë në dyshim apo të revizionojnë edhe disa postulate nacionaliste të njohura dhe të pranuar historikisht. Kështu, thënies “feja e shqiptarit është shqiptaria”, i kundërvihet thënia “më së pari jam mysliman, pastaj jam shqiptar”. Brenda të njëjtës logjikë e strategji, thënies “jam krenar që jam shqiptar” i kundërvihet thënia “jam krenar që jam mysliman”, e artikuluar shpesh sidomos në mediat online të fesë islame.

⁴⁷ Link: <http://observer.al/gjenocidi-kunder-muslimaneve-te-perandorise-osmane-qe-u-fsheh-per-100-vjet/>

Argumentet që sillen në këtë “betejë” të zhvlerësimit të identitetit kombëtar, shpesh janë të thjeshta, me sa duket, që të ngjisin më mirë në grupet e targetuara prej tyre. “Duhet të dihet njëherë e përgjithmonë se feja është para së gjithash, dhe në prizmin e fesë, d.m.th. asaj Islame shikohet edhe kombi...Krijimi i kombit është paraqitur shumë më vonë, ndërsa feja ka ekzistuar shumë, shumë përpara kombit.”⁴⁸ -thotë autori i shkrimit “Feja apo kombi: si e shqyrton feja islame këtë çështje”. Siç shihet, ky autor, aludon se kombet kanë lindur më vonë se feja, dhe rrjedhimisht sipas tij vijnë më pas edhe në renditjen hierarkike në raport me fenë.

Përveçse e thjeshtë, gjuha e diskursit që vë në plan të parë fenë është edhe e drejtpërdrejtë: “Unë kam fenë përpara dhe këtë e them me krenari dhe nuk e fsheh dot. Ai që e fsheh këtë nuk ka lidhje me islammin.”⁴⁹ Në këtë rast vihet re edhe inkurajimi për të shfaqur hapur përparësinë e fesë si dhe një lloj kushtëzimi që nënkupton se nëse kjo nuk shprehet hapur nga individë të caktuar, atëherë ata nuk kanë lidhje më islammin.

Qasja zhvlerësuese për identitetin kombëtar në raport me identitetin fetar, diku më e drejtpërdrejtë dhe diku më e tërthortë, është e pranishme edhe në shumë

⁴⁸ <http://www.albislam.com/feja-apo-kombi-si-e-shqyrton-feja-islame-kete-ceshtje/>

⁴⁹ <http://www.oranews.tv/vendi/gerti-pashaj-nje-nga-muslimanet-ne-kerkim-per-terrorizem-nga-turqia-jam-i-pafajshem/>

websajte të fesë Islame në gjuhën shqipe, sidomos tek ato që promovojnë shkollat fetare të ndryshme nga tradita Hanefi. Majft prej këtyre websajteve nuk lokalizohen në një vend të caktuar, duke ndjekur strategjinë e çterritorializimit dhe të krijimit të një ummaje virtuale globale. Pika e përbashkët e këtyre websajteve, siç vlerësohet në përgjithësi në plan global edhe nga Olivier Roy “është padyshim fakti i të krijuarit të një umme virtuale, të një komuniteti besimtarësh të shkëputur prej çdo kombi, çdo territori, madje edhe nga çdo kontekst social... Të gjitha sitet i referohen në fakt ummas së myslimanëve dhe nënvizojnë një identitet mysliman përtej prejardhjeve kombëtare ose etnike.”⁵⁰

Raporti komb/fe merr një rëndësi shumë të madhe sidomos po të kemi parasysh qasjen fundamentaliste të Islamit politik që promovon ndërtimin e një shoqërie mbarëbotërore në të cilën njerëzit i bashkon thjesht dhe vetëm feja dhe që ka si alternative të nënkuptuar apo të synuar konvertimin në një fe të vetme. Një optikë e tillë do të ishte përçarëse dhe asgjësuese për shoqërinë multifetare shqiptare. Për këtë arsye çdo lloj pikëpamjeje që sfidon apo kërkon përmbysjen e raportit identitet kombëtar/identitet fetar në favor të këtij të fundit, për realitetin shqiptar konsiderohet si tendencë apo shfaqje e ekstremizmit.

⁵⁰ Roy, Olivier, *Globalizimi i Islamit*, faqe 177, Botimet IDK, Tiranë, 2011

Rikontekstualizmi i historisë dhe vënia e saj nën optikën fetare

Si pjesë e diskursit ekstremist fetar, në dekadën e fundit është zhvilluar edhe një lloj qasjeje që synon një riinterpretim të historisë dhe vënie të saj nën optikën fetare. Prirje të tilla si tendenca për rikontekstualizimin apo fshirjen e historisë dhe injorimin e veçorive kombëtare, kulturave specifike si dhe të kontekstit social aktual, janë mes të tjerash edhe prirje tipike të islamizmit si ideologjike politike.

Një nga shfaqjet më të shpeshta të këtij diskursi në shoqërinë shqiptare është debati që synon një rishikim të historisë së Shqipërisë në periudhën e sundimit otoman. Territoret shqiptare u pushtuan për rreth 5 shekuj nga otomanët, dhe ky pushtim i tejzgjatur pati pasoja të konsiderueshme për vendin, duke nisur që nga konvertimi masiv i detyruar apo i imponuar i popullsisë në fenë islame deri tek vonesa e zhvillimit të gjuhës dhe të kulturës kombëtare.

Por në këndvështrimin ekstremist “Perandoria Osmane nuk ishte e keqe, siç e tregon historiografia jonë nacionalkatolike”.⁵¹ Duke e konsideruar historiografinë

⁵¹ <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-u-krijua-nga-perandoria-osmane-myslimanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

shqiptare si “nacional-katolike” autori që bën këtë deklaratë në media, paraqet edhe një qasje alternative të vetën për historinë e Shqipërisë në periudhën osmane, edhe pse nuk është historian. “Në shekullin e 14 dhe 15 Perandoria Osmane nuk pushtoi Shqipërinë, por pushtoi Bizantin dhe Venedikun.” - thotë ai. Dhe vijon: “Historiografia shqiptare, e cila u shkrua nga austriakët dhe italianët në fillim të shekullit të 20 është e mbarsur negativisht kundër Turqisë dhe Islamit, pasi këto dy fuqi evropiane donin t’i konvertonin shqiptarët në katolikë... Ndërsa radikalët katolikë kthehen në historikë, kur historianët e ndryshëm, rishpjegojnë historinë, besoj se koha do të vijë kur në tekstet tona shkollore ne do i mësojmë qytetarëve tanë, që përpara vitit 1912, ne shqiptarët kemi qenë osmanë”.⁵²

Në këto fjali, në mënyrë të koncentruar gjenden disa teza që po i serviren opinionit publik nga individë ekstremistë: Së pari, teza që sundimin pesë shekullor osman të Shqipërisë nuk e konsideron si pushtim. Së dyti, teza se lufta në periudhën osmane ishte një luftë fetare mes krishterimit dhe myslimanizmit dhe rrjedhimisht lufta kundër osmanëve ishte luftë kundër myslimanizmit. Së treti, teza se në këtë periudhë nuk ka ekzistuar ndonjë përpjekje për islamizim, përkundrazi

⁵² <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-u-krijua-nga-perandoria-osmane-myslimanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

ka ekzistuar një përpjekje për t'i konvertuar shqiptarët në katolikë. Së katërti, teza se para vitit 1912 shqiptarët kanë qenë osmanë, dhe rrjedhimisht kanë patur vetëm një identitet fetar dhe jo identitet kombëtar. Të gjitha këto teza, kanë të përbashkët prirjen ekstremiste për rikontekstualizim të historisë dhe vënien e saj nën optikën fetare islamiste.

Një prirje e tillë lexohet edhe në shkrimin “Gjenocidi kundër muslimanëve të Perandorisë Osmane që u fsheh për 100 vjet”, ku autori, luftën për pavarësi nga Perandoria osmane të vendeve të Ballkanit dhe të Europës në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit 20-të e sheh si një luftë për spastrimin etnik të muslimanëve të perandorisë otomane. Ai e paraqet Perandorinë otomane si një mbretëri ku ka mbizotëruar toleranca etnike dhe fetare “e cila u keqpërdor nga të huaj dhe nga të krishterët që jetonin brenda saj. Meqë Perandoria i respektonte liritë fetare, ajo nuk kishte planifikuar as kompaktësim demografik të muslimanëve, as segregim të të krishterëve, po kishte inkurajuar jetën e përbashkët në tolerancë e harmoni, gjë që u tregua fatale për vetë muslimanët... Me nxitjet nga jashtë, që nga kapitulacionet franceze, kultusprotektorati austro-hungarez e ai rus e deri te krijimi dhe financimi i organizatave terroriste kozake, armene, bullgare, greke e serbe, Rusia dhe Fuqitë e tjera Evropiane nxitën ideologjinë e urrejtjes tek të krishterët që ishin brenda

Perandorisë Osmane, deri sa ajo urrejtje u shndërrua në ideologji të gjenocidit, me synimin e zhdukjes fizike të çdo muslimani.”⁵³

Adhurimi i disa individëve ekstremistë për perandorinë otomane reflekton adhurimin për një shoqëri përtej kufijve kombëtarë, ku feja mbizotëruese ishte Islami dhe ku identiteti fetar ishte mbi atë kombëtar. Nostalgjia ndaj otomanizmit shpreh nostalgjinë për një nga përpjekjet e para të njohura në histori për të realizuar një lloj Kalifati, siç ishte perandoria otomane. Në situatat aktuale kjo nostalgji rezonon edhe me fushatën e islamit politik për krijimin e një mbretërie globale të qeverisur nga një interpretim i Sherihatit.

Nga ana tjetër viktimizimi historik i besimtarëve të fesë islame iu shërben strategjive aktuale për rizgjim të sensibiliteteve fetare dhe mobilizim në shërbim të Islamit politik. Ky lloj diskursi është veçanërisht i dëmshëm dhe i rrezikshëm në një vend multifetar siç është Shqipëria, pasi përveç mbjelljes së përçarjes fetare, mund të sjellë edhe një rritje të radikalizmit dhe ekstremizmit islamist në vend.

Pjesë e diskursit që lidhet me tezat për rishikimin e historisë së Shqipërisë në periudhën otomane janë edhe disa deklarata apo shkrime rreth Heroit Kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, që vijnë

⁵³ <http://observer.al/gjenocidi-kunder-muslimaneve-te-perandorise-osmane-qe-u-fsheh-per-100-vjet/>

gjithashtu nga mjedisi ekstremist fetar në Shqipëri apo në Kosovë. Kështu një deputet i pavarur i parlamentit të Kosovës deklaroi në media se ai nuk e konsideron si hero kombëtar Skënderbeun, por thjesht si një luftëtar të fesë së krishterë.⁵⁴ Një autor tjetër ekstremist shkoi edhe më tej: “Lufta fetare në emër të Papës dhe Jezu Krishtit që Skënderbeu bëri, në fund të fundit ishte një luftë terroriste katolike dhe aspak laike-kombëtare.”⁵⁵ -thotë ai

Në një përpjekje për të rikontekstualizuar luftën e heroit kombëtar të shqiptarëve dhe për ta vendosur atë në mënyrë absurde në kontekstin aktual, shkohet deri aty sa të bëhet një lloj krahasimi mes kësaj lufte dhe luftës së ISIS.

“Duke qenë se Skënderbeu u rebelua kundër shtetit të tij, d.m.th. Turqisë, vrau civilë dhe zyrtarë osmanë, dogji, preu e shkatërroi dhe vendin e shkretëtoi, e ndërtoi një ushtri klandestine kristianësh dhe banditësh, sipas klasikimeve moderne që ne kemi mbi terrorizmin, Skënderbeu i përmbush të gjithë kriteret për t’u klasifikuar si terrorist... Lufta që Skënderbeu bëri kundër shtetit

⁵⁴ <http://infojeta.net/index.php/2017/02/23/serish-gezim-kelmendi-skenderbeu-nuk-eshte-hero-kombetar-video/>

⁵⁵ <http://www.mediaelire.net/lajm/5184/skenderbeu-si-hero-terrorist-i-shqiptareve/>

osman, ideologjia e tij kristiane fundamentaliste, masakra kundër muslimanëve, besnikëria ndaj Papës së Romës, etj., nuk e ndryshojnë shumë luftën e Skënderbeut nga lufta e ISIS-it dhe e Abu Bakr al-Bagdadit. Sikur Abu Bakr al-Bagdadi, Skënderbeu i cili mori titullin Atlet i Krishtit nga Papa, pretendonte se kishte një mision hyjnor në luftën që ai bënte. Nëse Abu Bakri al-Bagdadi i vret njerëzit në emër të Islamit dhe pretendon se është kampion i muhamedanizmit, Skënderbeu luftën e tij e justifikoi në emër të Krishtit. Nëse Abu Bakr al-Bagdadi dhe ISIS-i mbështetet nga vehabizmi ndërkombëtar, edhe Skënderbeu u mbështet nga fundamentalizmi katolik evropian i kohës.⁵⁶

Krahas Skënderbeut, në shënjestër të ligjërimit ekstremist islamist është vënë edhe një tjetër figurë e krenarisë kombëtare shqiptare, Nënë Tereza. Duke kundërshtuar shpalljen e ditës së shenjtërimit të Nënë Terezës si festë zyrtare, një aktivist i fesë islame, i njohur për deklaratat e tij ekstremiste, thotë në një intervistë në media: “Qeveria jonë nuk duhet të shpallë festë kombëtare ditët e shenjtoreve katolikë”. Ai e argumenton këtë me faktin se në Shqipëri dhe Kosovë muslimanët përbëjnë shumicën kështu që ata “nuk mund të pranojnë

⁵⁶ <http://www.mediaelire.net/lajm/5184/skenderbeu-si-hero-terrorist-i-shqiptareve/>

si heronj të tyre figura që propaganda katolike i ka ndotur në vitet e fundit me simbole anti-muslimane⁵⁷. Brenda të njëjtës retorikë, në komentin e një shkrimi të botuar online thuhet “Nuk duhet nderuar kurrë ajo që thotë se i përkas Jezusit dhe mbarë njerëzimit. Po të ketë qenë e jona do na shërbente ne dhe do bëhej myslimane në emër të Allahut.”⁵⁸

Në fakt shqiptarët i kanë adhuruar dhe lartësuar Skënderbeun dhe Nënë Terezën për origjinën e tyre shqiptare dhe jo për origjinën fetare. Kontributet e tyre ata i kanë parë si pjesë e krenarisë dhe e përkatësisë kombëtare dhe jo si pjesë e ndonjë lloj krenarie apo përkatësie fetare. Diskursi ekstremist ndjek linjën e kundërt. Për t’i zhvlerësuar këto simbole kombëtarisht, ai përpiqet t’i “kompromentojë” fetarisht. Ky diskurs rreket të provojë se gjithçka jo-muslimane në Shqipëri është njëherësh edhe jo-kombëtare. Dhe rrjedhimisht, është kombëtare vetëm ajo që është myslimane.⁵⁹ Kështu, nën optikën islamiste figura të tilla si Skënderbeu dhe Nënë Tereza rezultojnë të jenë si figura të përçarjes

⁵⁷ <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-ukrijua-nga-perandoria-osmane-muslimanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

⁵⁸ <http://www.balkanweb.com/site/pse-e-leme-gonxhen-e-perjetshme-te-shqiptareve-ne-harrese/>

⁵⁹ *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, ISHM, faqe 41, Tiranë 2016

kombëtare dhe jo të unifikimit kombëtar, me argumentin se veprimtaria e tyre i përket apo është e lidhur me fenë e krishterë.

Një ri-intepretim i tillë i historisë kombëtare dhe i figurave emblematike të saj është qartazi ekstremist dhe krahas mbjelljes së urrejtjes ndaj feve të tjera jo-muslimane, mbart edhe rrezikun e përçarjes kombëtare. Shqetësues është fakti që kjo retorikë ka gjetur vend edhe në disa media kryesore, të cilat iu lënë hapësirë të konsiderueshme intervistave me eksponentë të deklaruar të ekstremizmit, duke iu dhënë mundësinë që të përhapin mesazhet e tyre në një publik më të gjerë. Një politikë e tillë editoriale ka vend të analizohet dhe të rishikohet nga redaksitë e mediave, pasi është në kundërshtim me interesat jetike të publikut të gjerë, që është kundër çdo forme të ekstremizmit fetar dhe dëshiron e aspiron harmoninë dhe tolerancën fetare.

Nga promovimi i salafizmit tek propogandimi i Kalifatit dhe i Sherihatit

Përpyjekjet e fondacioneve fetare nga Lindja e Mesme në vitet 1990-të për të futur në Shqipëri disa shkolla fetare ekstremiste nuk kaluan pa lënë gjurmë. Aktualisht mund të themi se në Shqipëri, Kosovë dhe në territoret e tjera të banuara nga shqiptarët janë të pranishme përveç

shkollës tradicionale Hanefi të Islamit, edhe disa rryma radikale të “importuara” kryesisht nga vendet arabe, siç janë salafizmi dhe vehabizmi. Mes tyre salafizmi rezulton të ketë edhe përkrahësit më të shumtë në Shqipëri e Kosovë.

Salafizmi, nga i cili buron edhe fundamentalizmi islamist i njohur ndryshe edhe si neofundamentalizmi, “është një lëvizje socio-politike që lindi në Egjipt në shekullin e 19-të në radhët e Islamit Sunit e cila iu kundërvu integritit me shoqëritë kryesore europiano-perëndimore. Salafistët besojnë se myslimanët duhet të kthehen në rrugën e Profetit dhe t’i përmbahen fjalë për fjalë Kuranit. Duke patur parasysh mënyrën e tyre fetare konservatore të jetesës, të gjithë salafistët mund të konsiderohen fundamentalistë, por jo të gjithë janë militantë të dhunshëm. Vetëm xhihadizmi salafist fokusohet në përdorimin e dhunës për të sjellë ndryshimin shoqëror. Xhihadistët evokojnë përdorimin e dhunës për të krijuar një Kalifat të ri dhe për të fituar territoret që dikur kanë qenë sunduar nga myslimanët. Në ndjekje të mësimëve të tyre, xhihadistët refuzojnë pluralizmin fetar dhe aspirojnë tek dominanca e Islamit politik në të gjithë botën.”⁶⁰

⁶⁰ *Religious fundamentalism and radicalisation*, Parlamenti European, European Parliamentary Research Service, Autore: Anita Orav, f.3

Aktualisht në Shqipëri dhe në Kosovë salafizmi ka predikuesit e vet në gjuhën shqipe, të cilët janë shkolluar kryesisht në vendet arabe. Madje janë bërë edhe përpjekje për organizimin institucional të selefijve dhe të salafizmit. Në vitin 2014 mediat raportonin për një inisiativë për të krijuar bashkësinë e imamëve salafistë në Kosovë.⁶¹ Ndërkohë në mjedisin online, infrastruktura paraqitet më e plotësuar. Në të gjenden shumë websajta që i dedikohen mësimin të fesë Islame sipas interpretimit të kësaj shkolle apo të shkollave të tjera të përafërta. Madje, siç e kemi përmendur edhe më sipër, në gjuhën shqipe aktualisht botohet edhe një websajt i vetëquajtur “faqja e selefijve shqiptarë” që i dedikohet posaçërisht salafizmit.

Shqetësimi për shfaqjen dhe praninë e salafizmit në hapësirën fetare shqiptare nuk ka të bëjë thjesht me faktin se është shtuar edhe një shkollë tjetër e interpretimit të Islamit. Duke shfrytëzuar faktin që kjo rrymë është pjesë e Islamit Sunit, të cilit i përket edhe shkolla tradicionale Hanefi e islamit shqiptar, imamët që predikojnë salafizmin po “pushtojnë” njera pas tjetrës xhamitë, madje edhe ato që janë nën kontrollin e KSHM dhe po depërtojnë me agresivitet edhe në rangjet drejtuese të komunitetit Islamik Sunit në Shqipëri

⁶¹ <https://m.gazetaexpress.com/lajme/si-provuan-imamet-salafi-te-krijonin-bashkesine-e-tyre-islame-ne-kosove-foto-310568/?archive=1>

e Kosovë. Një pjesë e mirë e klerikëve në moshë të re që kanë studjuar jashtë vendit, ose janë të shkollës salafiste, ose kanë qenë të ndikuar prej kësaj rryme. Kjo situatë është denoncuar edhe në media: “Tash bëhet përpjekje, e një pakice të vogël, që forma tradicionale e islamit të ndryshojë, madje rrënjësisht. E kur kemi të bëjmë me një traditë qindravjeçare, është e qartë se ajo nuk mundet të shndërrohet kaq shpejt. E vetmja formë e shndërrimit të shpejtë është dhuna, e kombinuar me trysninë e parasë, dhe për fat të keq kjo po ndodh. Sot po bëhen përpjekje që interpretimi shqiptar i islamit t’u nënshtrohet interesave politike të grupeve islamike apo edhe shteteve që e sponsorizojnë atë.”⁶²

Krahas zgjerimit të sferave të influencës dhe të kontrollit, salafistët por promovojnë edhe modelin shoqëror të Kalifatit. Sipas perspektivës salafiste, bota duhet të shkojë drejt një shoqërie pa kufij kombëtarë ku njerëzit bashkohen nga feja dhe drejtohen nga kalifët që konsiderohen si pasardhës të profetit Muhamed. Ideja e krijimit të një kalifati të tillë është edhe qëllimi final i luftës së ISIS në territoret siriane dhe irakiane. Në mediat shqiptare është raportuar edhe për një video të ISIS që propogandon krijimin e një Kalifati Ballkanik.⁶³

⁶² *Shoqëritë tona të sulmuara nga islami politik*, [Gazeta Shqip](#), 30 Gusht 2015

⁶³ <https://www.reporter.al/video-propagandistike-e-isis-kerkon-krijimin-e-kalifatit-ballkanik/>

Kalifati është bërë pjesë e retorikës së individëve ekstremistë shqiptarë të shfaqur edhe në media. Në një intervistë, një personazh i akuzuar për lidhje me ISIS, deklaroi: “Kalifati është një vend i mirë për të jetuar nëse je besimtar mysliman.”⁶⁴ Në të njëjtën linjë deklarohet edhe imami i njëjës prej xhamive në Tiranë që është jashtë kontrollit të KMSH: “Çdo mysliman i vërtetë i pëlqen të jetojë aty ku gjykohet me ligjin Islam. Çdo mysliman i sinqertë do të donte të jetonte me ligjin islamik në Kalifat”⁶⁵ – thotë ai.

Duke qenë antioksidant që në origjinë, ekstremizmi fetar islamik ndjek një linjë refuzuese ndaj modelit perëndimor liberal-demokratik të organizimit të shoqërisë. Në mediat online në gjuhën shqipe citohet Taip Erdogan, presidenti i Turqisë të ketë thënë: “Demokracia nuk është qëllimi ynë. Ajo është vetëm një mjet për të arritur një qëllim dhe jo qëllimi në vetvete. Demokracia është si një tren. Ne do të ulemi kur të arrijmë në stacionin që dëshirojmë.”

Në një shkrim tjetër me titull “Moderniteti kriminal” argumentohet se është më mirë të kthehemi në mesjetën e Islamit të dikurshëm se sa të pranojmë modernitetin e shoqërive perëndimore që për autorin konsiderohet si

⁶⁴ <http://www.reporter.al/toleranca-ne-prove-shqiperia-perballe-sfides-se-radikalizmit/>

⁶⁵ <http://www.mapo.al/2015/11/imami-shqiptar-francezet-sjane-me-te-mire-se-lavdrim-muhaxheri/1>

“rend i kalbur” dhe kriminal. “Disa thonë se po i kthehemi mesjetës! Me këto që na shohin sytë sot, në fakt mesjeta si për nga mundësitë teknologjike, masiviteti i krimit dhe ndjeshmëria njerëzore do ta përqeshte aktualen moderne me talljen dhe denigrimin që kjo e fundit i ka bërë asaj, ndërkohë që vetë po del se është me zezë, e njëanshme dhe kriminale sesa epoka që la pas, mbi gërmadhat e së cilës ajo i dha legjitimitet vetes. Rend i kalbur, që veç mirëqenies për disa ka prodhuar po aq edhe më shumë mjerim dhe errësi njerëzore... Zot! Jepi fundin edhe kësaj si të tjerat!”⁶⁶

Salafizmi kërkon ndër të tjera që veprimet dhe sjelljet njerëzore t'i nënshtrohen normës islamike dhe Sherihatit dhe si rrjedhojë refuzon nocionet perëndimore të demokracisë, lirisë, të shtetit ligjor, të barazisë gjinore, të të drejtave të njeriut, etj. Salafistët proklamojnë se sovraniteti politik i përket Zotit dhe jo njerëzve dhe leximi i tyre i Sherihatit duhet të jetë ligji i shtetit. Në një websajt paraqiten edhe të dhëna që pretendohet të jenë marrë nga një studim i Pew Research Institute sipas të cilave 12% e myslimanëve të Shqipërisë dhe 20% e myslimanëve të Kosovës duan zbatimin e ligjit të Sherihatit në vendin e tyre.

Në mediat online në gjuhën shqipe aktualisht është e pranishme gjithashtu një literaturë dhe një ligjërim i gjerë që u ofron besimtarëve myslimanë, por edhe të

⁶⁶ <http://www.albislam.com/moderniteti-kriminal/>

tjerëve, mënyrën islamiste të jetesës dhe të kuptuarit të botës. Edhe pse shqiptarët në Shqipëri, Kosovë dhe në Ballkan jetojnë në vende sekulariste ku vepron shteti ligjor dhe ku praktikohet mënyra liberal-demokratike e jetesës, këto websajta u ofrojnë atyre një alternativë tjetër: atë të Sherihatit. Kështu gjenden mjaft shkrime ku shtjellohet se si trajtohet gruaja në Sherihat, si trajtohet divorci, si kryhet punësimi i femrës sipas pikëpamjes së Sherihatit, si zgjidhen problemet e huamarrjes apo të pronës sipas fesë islame, a duhet të ndjekë shkollën e juridikut një mysliman, si ndëshkohet homoseksualiteti në Islam, dhe deri tek dilema të tilla si: a duhet ndaluar futboli për myslimanët, a duhet ngrënë mishi i therur nga i krishteri ose muslimani jopraktikant, apo a duhet lexuar Kurani nga gruaja kur ajo është me menstruacione⁶⁷.

Është e natyrshme që mediat fetare online apo offline të merren me edukimin fetar dhe me njohjen nga ana e besimtarëve të shpjegimeve që jep feja për mjaft pyetje apo situata. Deri këtu gjithçka është në rregull. Problemi nis atëhere kur ofrohen interpretime radikale të aplikueshme vetëm në vendet monofetare që dallohen për Islamin radikal dhe që nuk kanë asnjë lidhje me kontekstin shqiptar, ku ka ekzistuar një formë shumë tolerante e Islamit. Kështu në Shqipëri dhe në përgjithësi në hapësirën shqiptare nuk kanë qenë të

⁶⁷ <https://besimtare.wordpress.com/2016/12/27/leximi-i-kuranit-nga-gruaja-me-menstruacione/>

aplikueshme në masë disa rregulla strikte të Islamit si mbulimi i gruas me perçe, ndalimi i punësimit të saj jashtë shtëpisë, kufizimi i të drejtave të gruas, e të tjera si këto. Në përgjithësi, siç thekson edhe Veton Surroi, “Islami tradicional shqiptar është ndërtuar mbi traditën e bashkëkohësisë, logjikë e shkollës Hanefi të interpretimit të Islamit. Kjo do të thotë që fenomenet e sotme duhej të interpretohen jo nëpërmjet të leximit tekstual të Kuranit, por nëpërmjet të logjikës, brenda kornizës teologjike Islame.”⁶⁸

Gjithashtu në Islamit shqiptar nuk ekzistojnë ose janë tepër të zbehta antisekularizmi, totalitarizmi apo anti-oksidentalizmi, që janë tipare të qenësishme të Islamit radikal dhe të salafizmit. Në këto kushte, për kontekstin shqiptar, propaganda apo qasjet që nxisin aplikimin e rregullave strikte dhe të një forme radikale të Islamit në Shqipëri, nuk mund të jetë veçse një propogandë ekstremiste.

Islamofobia mes kauzës dhe alibisë

Diskursi rreth Islamofobisë është relativisht i ri në mjedisin shqiptar. Ai paraqitet si pjesë e ligjërimit fetar, politik dhe mediatik. Diskutimi nis që me pyetjen nëse

⁶⁸ <http://www.lapsi.al/ide/2015/11/27/terrorizmi-pse-ne-jemi-m%C3%AB-t%C3%AB-rrezikuarit#.WSNPI-uGOM8>

ekziston apo jo Islamofobia në Shqipëri. Lidhur me këtë pyetje, në media dhe në komunikimin masiv në përgjithësi paraqiten dy lloje qasjesh të skajshme:

Në njërin skaj qëndrojnë ata që mohojnë ekzistencën e kësaj dukurie në vend. Kështu, autori i një studimi mbi radikalizmin fetar, vë në dukje se për shkak të harmonisë fetare islamofobia nuk është shfaqur asnjëherë në Shqipëri. Ai thekson se nuk duhet ngatërruar islamofobia me diskriminimin për shkak të besimit fetar mysliman duke nënvizuar se edhe ky i fundit është hasur në raste shumë të rralla dhe vetëm gjatë viteve të fundit.⁶⁹ Një autor tjetër e konsideron islamofobinë si një term pa kuptim. Ai argumenton: “Kritika ndaj religjionit dhe profetëve nuk është islamofobi. Më shpjegoni sa prej jush keni dëgjuar termin kristianofobi? Në vendet perëndimore libraritë dhe bibliotekat kanë mijëra publikime të personave që kritikojnë krishterimin dhe asnjëherë nuk kam rastisur të dëgjoj të thirren si “kristianofobë.” Keni dëgjuar diku se një kritik i demokracisë të quhet demokratofob, apo një kritik i fashizmit të etiketohet si fashistofob? Nuk ka. Këtë e gjeni vetëm tek kritika ndaj Islamit dhe prandaj nëse kërkonti debat serioz është shumë joserioze përdorimi termave që nuk kanë kurrfarë kuptimi.”⁷⁰

⁶⁹ Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 22, AIIS, Tiranë, 2015

⁷⁰ <https://www.gazetaexpress.com/oped/islamofobia-myslimanofobia-dhe-sekularet-fundamentaliste-208098/>

Në skajin tjetër qëndrojnë ata që e shohin Islamofobinë në Shqipëri dhe në Kosovë si “gjendje dominante”, e lidhur me “politikën e brendshme islamofobike të shteteve ku jetojnë shqiptarët”.⁷¹ Flitet gjithashtu për Islamofobi të tepruar nga mediat e ndryshme dhe të ushqyer nga rrjetet sociale apo për presion mediatik islamofob.⁷² Brenda qasjeje së këtij skaji dallohen dy grupime: Një grup që luftën kundër Islamofobisë e ka ndërtuar si një kauzë për denoncimin e të gjitha rasteve të diskriminimit apo të përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj Islamit dhe Myslimanëve. Kështu, përshembull, themeluesit e Observatorit Kombëtar Kundër Islamofobisë deklarojnë se “të nxitur nga problemet me të cilat përballlet shoqëria jonë në përgjithësi dhe muslimanët në veçanti, e kanë parë të nevojshme hapjen e një platforme online ku të trajtohet me profesionalizëm problemi i Islamofobisë, racizmit dhe gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit Musliman Shqiptar e më gjerë.” Krahas këtij grupi ekziston edhe një grupim tjetër që luftën kundër Islamofobisë e ka si alibi për të maskuar apo për të mbështetur propagandën dhe veprimtarinë ekstremiste.

Është e qartë se qëndrimet e mësipërme lidhen me kuptimin që ka secili individ apo grup për Islamofobinë

⁷¹ <http://observer.al/gjenocidi-kunder-muslimaneve-te-perandorise-osmane-qe-u-fsheh-per-100-vjet/>

⁷² <http://observer.al/rreth-nesh/>

dhe me përkufizimet që ata ofrojnë për të. Një nga autorët që mohon ekzistencën e islamofobisë në Shqipëri, e përkufizon atë si “armiqësia e pabazuar kundër myslimanëve dhe frika ose përçmimi i të gjithë komunitetit mysliman”⁷³ Ndërkohë nga grupimi që luftën kundër Islamofobisë e ka ndërtuar si një kauzë, vjen ky përkufizim: “Kur flasim për Islamofobinë, ne kuptojmë racizmin anti-mysliman... Kriticizmi ndaj myslimanëve apo ndaj fesë Islame nuk është domosdoshmërisht Islamofobi. Islamofobia lidhet me një grup dominant individësh që kanë për qëllim marrjen, stabilizimin dhe zgjerimin e pushtetit të tyre përmes krijimit të një dashi kurban – real apo të sajuar – dhe përmes përjashtimit të këtij dashi kurban nga burimet, të drejtat dhe përkufizimi i konstruktit “ne”. Islamofobia operon përmes ndërtimit të një identiteti statik “Mysliman”, i cili atribuohet në terma negativë dhe përgjithësues për të gjithë myslimanët.”⁷⁴

Kryetari i Komuniteti Mysliman Shqiptar, lidhur me debatin për Islamofobinë, në një intervistë në media shprehet:

“Ku ka njerëz, ka fobi. Ka trembje nga shumë gjëra e mbi të gjitha nga e panjohura. Nëse një individ

⁷³ Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, faqe 22, AIIS, Tiranë, 2015

⁷⁴ <http://www.islamophobiaeurope.com/wp-content/uploads/2017/03/ALBANIA.pdf>

nuk ka një mik ose një shok që është një mysliman i mirë dhe di të bëjë diferencën, patjetër që ka fobi se nuk ka komunikim. Unë deri diku nuk e keqkuptoj islamofobinë që kanë njerëzit, por unë sugjeroj që të arrijnë tek konceptet dhe të njohin mirë se çfarë është gjëja që kanë fobi. A kemi fobi disa individë të caktuar që keqpërdorin fenë apo është Islami ai që duhet të kemi frikë? Ndaj besoj që nuk është i drejtë termi islamofobi, është një rrymë e caktuar që përfaqëson një ideologji të caktuar dhe që s'ka lidhje me Islamin. Media këtu mund të ketë kontributin e vet për ta ulur apo rritur islamofobinë. Ndërsa njerëzit duhet të jenë më të kujdesshëm në frikërat apo fyerjet ndaj fesë të tjetrit, jashtë normave të etikës, sepse pastaj do të ketë probleme dhe keqinterpretime. Ekstremistët prodhohen edhe nga kjo lloj kauze dhe marrin më tepër energji prej saj, duke u ushqyer me këtë lloj kauze.”⁷⁵

Siç shihet kemi një larmi këndvështrimesh, përkufizimesh dhe qëndrimesh të shfaqura edhe në media. Ajo që është shqetësuese në kontekstin shqiptar është përdorimi i Islamofobisë si alibi dhe si pjesë e strategjisë apo e ligjërimit ekstremist islamist. Kështu

⁷⁵ <http://www.lapsi.al/lajme/2015/01/09/kreu-i-komunitetit-mysliman-isis-%C3%ABsht%C3%AB-kanceri-i-shoq%C3%ABris%C3%AB-s%C3%AB-sotme#.VjE2YdKrS70>

rasti i arrestimit të një mësueseje që bënte propogandë për ISIS dhe shprehte simpati për Bin Ladenin në orën e mësimit me nxënësit e një medreseje, konsiderohet nga një autor si një rast “që tregon histerinë islamofobike të kësaj qeverie”⁷⁶. Autorë të tjerë konsiderojnë si shfaqje të Islamofobisë kritikizmin ndaj Islamizmit si ideologji politike apo arrestimin e disa imamëve të akuzuar për veprimtari esktrmiste. Nuk mungojnë edhe teoritë konspirative, sipas të cilave “Bota Perëndimore për të justifikuar luftën e saj plaçkitëse në Lindje të Afërt dhe atë të Mesëm, shpiku “Islamofobinë” dhe “Terrorizmin Islam”.⁷⁷ Në mediat online ndeshen edhe komente që i lidhin aktet terroriste me rritjen sipas tyre të Islamofobisë.

Ndodh në këtë mënyrë ajo që konstaton analisti dhe studiuesi Veton Surroi: “Terrorizmi dhe dhuna që ai përdor... janë pjesë e strategjisë, e krijimit të vetëdijshëm të distancës mes myslimanëve dhe “të tjerëve”. Çdo vrasje e “të tjerëve” duhet të nxisë animozitetin ndaj Islamit deri në Islamofobi dhe duhet të shërbejë që myslimanët të lidhen, si në çdo konflikt, me njërën anë. Me atë të “tyren”. Dhe, njëherë të lidhur me “anën e tyre”, të bëhen objekt i trajtimit me paragjykim që ndërton

⁷⁶ <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-ukrijua-nga-perandoria-osmane-myslmanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

⁷⁷ <http://www.tetovasot.com/2017/05/pse-islamofobia/>

Islamofobinë. Islamizmi dhe islamofobia, kështu, janë të përcaktuar që ta ushqejnë njëri tjetrin.”⁷⁸

Në mediat e Kosovës konstatohet se Islamofobia po përdoret si tendencë relativizuese ndaj ekstremizimit fetar. “Kësisoj, grupeve ekstremiste fetare në Kosovë i është vënë përballë lansimi i tezës së islamofobisë, në mënyrë që problemi i parë të mos shihet si i tillë, por të zhvendoset në taborin e problemit të shoqërisë kosovare me islamin. Prandaj, shpikja e konceptit të islamofobisë në kontekstin kosovar, nuk është përpjekje adekuate për të shënuar një gjendje të caktuar psikologjike dhe sociale që ka kjo shoqëri... Në Kosovë nuk ka islamofobi, por fobi ndaj veprimeve që synojnë të prishin kohezionin brenda komunitetit mysliman, por edhe në relacion me komunitetet e tjera. Kësaj fobie duhet t’i gjendet antidoti, sepse rreziku nuk vjen nga komunitetet religjioze pakicë, porse nga ai që përbën shumicën. E paqen e çfarëdoshme, në çdo vend e çdo kohë e siguron shumica!”⁷⁹

Diskursi anti-perëndimor dhe anti-amerikan

Në momentet kyçe të historisë, kur vendi është ndodhur në udhëkryqe epokash, shqiptarët në një

⁷⁸ <http://www.lapsi.al/ide/2015/11/27/terrorizmi-pse-ne-jemi-m%C3%AB-t%C3%AB-rrezikuarit#.WSNPI-uGOM8>

⁷⁹ <https://sbunker.net/op-ed/37303/islamofobia-tendence-relativizuese-ndaj-ekstremizimit-fetar/>

shumicë absolute e kanë gjetur drejtimin e busullës nga Perëndimi. Në kohën e shkëputjes nga perandoria otomane, rilindasit do të bënin të qartë se për Shqipërinë “dielli lind andej nga perëndon”. Kurse demonstratat për rrëzimin e komunizmit, kishin si promotor thirrjen “E duam Shqipërinë si gjithë Europa.” Një sondazh i kryer para pak vitesh, nxori në pah se mbi 90 përqind e shqiptarëve ishte pro integritimit europian, një shifër kjo më e lartë nga çdo vend tjetër i Europës Lindore.

Anti-okcidentalizmi në Shqipëri pothuaj nuk ka ekzistuar. Deri në momentin kur në terrenin shqiptar do të shfaqeshin dy nga ideologjitë politike më ekstremiste të shekullit 20-të: komunizmi dhe islamizmi, të cilat, pavarësisht nga diferencat, i bashkon urrejtja dhe lufta ndaj liberal-demokracisë.

Diskursi anti-perëndimor i frymëzuar apo i gjeneruar nga ekstremizmi fetar është një dukuri që ka lindur gjatë dy dekadave të fundit në Shqipëri, pikërisht në kohën kur në vend depërtuan shkollat radikale të mësimin të Islamit, dhe bashkë me to edhe idetë dhe propaganda islamiste. Analiza e përmbajtjes së disa shkrimeve të botuara në shtyp dhe në median online, zbulon praninë e këtij diskursi edhe në komunikimin masiv publik që zhvillohet në Shqipëri.

Një pjesë e ligjërit të këtij diskursi, paraqitet i moderuar, në trajtën e komenteve të përgjithshme fetare, politike, filozofike dhe historike, por që nuk

përmbajnë urrejtje apo qasje aprovuese ndaj dhunës. Përgjithësisht materialet e kësaj kategorie përpiqen të argumentojnë tezat për “fundin e modernitetit dhe të modelit liberal-demokratik të shoqërive perëndimore”, për “konkurrencën e faktorizimit të opsionit të zgjidhjes islame”, “për lindjen e qytetërimit të ri Islamik” apo të “një rendi të ri botëror të bazuar tek Islami”.

Në disa shkrime të tjera shfaqet një përmbajtje fetare apo ideologjike më konservatore dhe izolacioniste, politikisht radikale dhe konfrontuese, e cila edhe pse nuk përmban justifikime për dhunën në skenaret aktuale, i hap vend shprehjes së zemërimit apo të armiqësisë ndaj Perëndimit. Në shkrimet e kësaj kategorie ka raste kur gjuha e zemërimit merr edhe trajtat e gjuhës së urrejtjes. Brenda kësaj kategorie dallohen përpjekjet e disa autorëve apo individëve ekstremistë për të fajësuar Perëndimin dhe SHBA për të gjitha konfliktet, luftërat dhe gjer tek krijimi i ISIS apo aktet terroriste që ndodhin kudo në botë.

Kështu një autor nuk ngurron të deklarojë zbulimin dhe bindjen e tij se vetë ISIS dhe organizatat e tjera xhihadiste janë krijuar nga Perëndimi; “ISIS-i ashtu sikur edhe organizatat e tjera xhihadiste në Siri u krijuan nga Perëndimi, në kohën e pranverës arabe. Ideja ishte që të rrëzonin regjimin e Asadit si filorus që ai ishte dhe në vend të tij, ta kthenin vendin në një Afganistan të dytë. Destabilizimi i Sirisë i shërbente Izraelit, NATO-s

dhe aleatëve arabë të Amerikës. Ka shumë studime akademike, por edhe ndërhyrja ruse në Siri, apo akuzat e fundit të qeverisë turke, që tregojnë që ISIS është krijuar nga agjencurat perëndimore. Qëllimi pas krijimit të ISIS-it ishte nxitja e luftës civile në botën arabe.”⁸⁰

Si për t’i shkuar deri në fund strategjisë së gjetjes së fajit dhe fajtorëve në anën e Perëndimit, i njëjti autor zbulon se edhe terrorizmi është një dukuri gjenuine europiane. Ai thotë: “Terrorizmi si ideologji është shpikur në Evropë dhe është ideologji radikale moderniste që nuk ka lidhje me fetë, të cilat thërrasin njerëzit që të besojnë në Zot dhe t’i largohen krimeve dhe luftës. Terrorizmi është dukuri e diktaturave, sikur diktatura naziste që krijoi Holokaustin, apo diktatura që republikanët francezë zbatuan në Francë kundër popullit kur krijuan republikën e tyre masonike me Robespierin.”⁸¹

Në disa raste termat e urrejtjes dhe të anatemit ndaj Perëndimit janë në të njëjtën lartësi amplitude me termat e përdorura nga ekstremistët në Lindjen e Mesme apo rezonojnë me disa nga tezat kryesore të propogandës së ISIS, duke verifikuar kështu praninë e argumenteve apo të refleksive të kësaj propagande

⁸⁰ <http://www.gazetatema.net/2017/01/20/shqiptaret-para-1912-s-kane-qene-osmane-ne-kemi-qene-turq-dhe-kombi-yne-u-krijua-nga-perandoria-osmane-muslimanet-smund-ta-pranojne-si-hero-skenderbeun/>

⁸¹ Po aty

në hapësirën shqiptare. Ja si shkruan një autor në një media online: “Gjithnjë, por edhe sot Perëndimi kishte planifikuar t’i shkelë brutalisht dëshirat e popujve islamë, gjë që do të ushtrohej me anë të luftërave selektive përmes organizmave kriminele me pamje islame të rekrutuar brenda organizatave terroriste, që do të përhapnin dhunë e terror si luftë speciale për t’i frikësuar masat e gjëra popullore, ndërsa në anën tjetër përmes masmediave shpiku “Islamofobinë” ose frikësimin e njeriut perëndimor nga besimi islam dhe së fundi duke dëshiruar t’i frustrojë muslimanët legalizoi Homoseksualizmin ose LGBT-në, si kusht për t’u futur në familjen e përbashkët të BE-së, gjë e dënuar skajshmërisht nga Zoti dhe besimi Islam. Me këto akte neveritëse provokoi revoltën e muslimanëve për t’i treguar si barbarë të rrezikshëm dhe si shpëtim prej islamit radikal do të sponsorizojë si nus produkt industrial “Dialogun Ndër-religjionesh” mbi tolerancën fetare ose një “Islam të moderuar”, nën etiketën “Hallall..!?”⁸²

Në disa raste diskursi anti-perëndimor dhe anti-amerikan shfaqet edhe si refleks apo ndikim i ideologjive të ekstremit të majtë, të cilat vijojnë të jenë të pranishme në vend, edhe pse ka kaluar më shumë se një çerek shekulli nga rënia e komunizmit. Një autor në analizën e tij të botuar edhe në shtyp, thotë: “Vetë bota e

⁸² <http://www.tetovasot.com/2017/05/pse-islamofobia/>

zhvilluar (e grupuar në G-7 apo G-20) është përgjegjëse për luftërat e gabuara, për heshtjet, ngurrimet dhe vonesat, apo luftërat e bëra keq në këtë rajon. Ajo është përgjegjëse për thellimin e pabarazisë ekonomike mes saj dhe pjesës tjetër të botës.”⁸³

I pranishëm në media është edhe një diskurs i përgjithshëm anti-luftë, që në thelb është kundër ndërhyrjes ushtarake të Perëndimit në konfliktin e krijuar nga ISIS. Në kuadër të diskursit anti-perëndimor nuk mungojnë edhe shkrimet që botojnë apo trajtojnë supozime dhe teori konspiracioni, sipas të cilave mjaft akte terroriste mund të jenë organizuar nga agjenturat perëndimore, për të nxitur urrejtjen ndaj Islamit dhe myslimanëve.

E inkuadruar në diskursin ekstremist anti-perëndimor paraqitet edhe teza e standarteve të dyfishta. Sipas kësaj teze, shoqëritë dhe mediat perëndimore trajtojnë me standarte të dyfishta aktet terroriste që kryhen në Europë dhe ato që kryhen në Lindjen e Mesme apo në vende të tjera jo perëndimore të botës dhe “pikërisht ky standard i dyfishtë po e shkatërron botën.”

Mjaft problematik në kuadrin e diskursit ekstremist mbetet diskursi që justifikon, glorifikon dhe promovon dhunën ekstreme. Kështu mediat raportojnë për

⁸³ <http://www.balkanweb.com/gazetashqiptare/bota-ne-prag-lufte-po-ne/>

deklaratat e një prej xhihadistëve shqiptarë që lufton në frontin e ISIS i cili bën thirrje për “sulme me thika dhe bomba” në Shqipëri⁸⁴, apo për deklarimin e anëtarit të një grupi xhihadist shqiptar në Itali, i cili thotë se “me 50 mijë vetë e shkatërrojmë Europën”.⁸⁵ Duhet theksuar se ky lloj diskursi është i denoncuar nga mediat shqiptare dhe jo pjesë e përmbajtjes së tyre

⁸⁴ <http://www.gazetatema.net/2017/05/07/isis-kercenon-shqiperine-lavdrim-muhaxheri-prisni-sulme-me-thika-dhe-makina-bombe/>

⁸⁵ <http://www.citynews.al/2017/04/me-50-mije-vete-shkaterrojme-evropenzbardhen-pergjimet-e-xhihadisteve-shqiptare-video/1>

5

Përmbledhje ekzekutive

Forma më e përhapur dhe më aktive e diskursit fetar ekstremist në Shqipëri, siç rezulton edhe nga kërkimi i kryer në kuadër të këtij studimi, është diskursi ekstremist islamist. Në kontekstin shqiptar, radikalizmi dhe ekstremizmi fetar, edhe pse në fazë embrionale mund të krijojnë terren për lindjen e konflikteve me bazë fetare, duke cënuar kështu një nga shtyllat kryesore të shoqërisë: harmoninë dhe tolerancën fetare.

Ky studim ka për qëllim që të hedhë dritë mbi përmasat dhe shkallën e përhapjes së diskursit fetar ekstremist fetar si dhe mbi praninë e tij në mediat shqiptare, për të ndihmuar në arritjen e përfundimeve dhe në marrjen e masave për parandalimin apo minimizimin e tij.

Në përgjithësi historia dhe tradita fetare shqiptare karakterizohen nga mungesa e konflikteve dhe e përplasjeve masive me bazë fetare, nga respekti i ndërsjelltë, pranimi dhe toleranca mes besimtarëve të besimeve të ndryshme si dhe nga mungesa e një qasjeje fundamentaliste ndaj fesë. Një rol të madh në këtë mes ka luajtur ekzistenca e një forme tradicionale tolerante

të Islamit të praktikuar nga shqiptarët. Gjithashtu, nga studiuesit është vënë në dukje se historikisht ka ekzistuar edhe një prevalencë e identitetit kombëtar ndaj atij fetar.

Por depërtimi i disa fondacioneve nga Lindja e Mesme në vitet '90 shënoi për herë të parë në historinë e Shqipërisë jo vetëm futjen e disa shkollave të reja radikale të mësimit të fesë Islame, të cilat ishin larg nga tradita Hanefi e Islamit shqiptar, por edhe krijimin e bazave për lindjen e radikalizmit dhe ekstremizmit islamist në vend. Krahas ligjërimit radikal në disa xhami të vendit, diskursi ekstremist është shfaqur edhe në media. Shqetësuese është sidomos prania e një diskursi intensiv islamist që zhvillohet në hapësirën online në gjuhën shqipe, ku vihet re një numër i madh websajtesh që promovojnë gjithfarë shkollash të huaja të interpretimit të Islamit, që nga ato më të moderuarat deri tek ato të ekstremit të skajshëm. Mes tyre salafizmi rezulton të ketë edhe përkrahësit më të shumtë në Shqipëri e Kosovë.

Përveç formave të ekstremizmit islamist, në raste tepër të izoluara është verifikuar edhe prania e dy formave të tjera të ekstremizmit: ekstremizmit anti-Islam dhe ekstremizmit ateist. Ndërkohë mund të thuhet se ndaj ekstremizmit fetar nuk është e ekspozuar vetëm feja Islame, por edhe komunitetet e tjera fetare.

Disa studime që janë ndërmarrë në Shqipëri e vlerësojnë situatën e ekstremizmit fetar si “një dukuri

në fazë të hershme”, “embrionale” ose si një “zhvillim në fazë fillestare”. Por njëherësh këto studime i shohin zhvillimet si një kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, që përmban edhe rrezikun e cënimit të harmonisë fetare, çka do të ishte fatale për sigurinë, stabilitetin, madje edhe për të ardhmen e vendit.

Lidhur me informacionin që lidhet me fenë, në Shqipëri, kanalet kryesore të tij janë mediat tradicionale dhe mediat online. Këtu përfshihen edhe mediat e vetë komuniteteve fetare apo të organizatave dhe individëve të përfshirë në komunikimin fetar. Sakaq, një kanal i rëndësishëm komunikimi mbetet edhe ligjërimi brenda objekteve të kultit si dhe komunikimi ndërpersonal. Ky i fundit konsiderohet i aplikueshëm me përparësi në rastet e shkëmbimeve komunikative me natyrë fondamentaliste dhe ekstremiste. Por janë verifikuar raste të propagandës ekstremiste edhe në ligjërimin e kryer në disa objekte kulti të fesë Islame që kanë qenë jashtë kontrollit të KMSH.

Nga monitorimi dhe analiza e kryer në kuadër të këtij studimi, mund të thuhet se mediat dhe kanalet institucionale të komunikimit masiv të komuniteteve fetare kanë qenë korrekte në kryerjen e misionit të tyre religjioz dhe kanë ndërtuar e përcjellë një komunikim i cili ka mbartur frymën e respektit të ndërsjelltë mes besimtarëve, tolerancën dhe harmoninë që kanë mbizotëruar në traditën fetare shqiptare.

Kurse nga monitorimi i mediave kryesore në Shqipëri, qofshin media të printuara, televizive apo radiofonike, rezulton se ato raportojnë për fenë dhe zhvillimet që lidhen me të, kryesisht në rastet e festave të shënuara fetare, në rastet e konflikteve apo përplasjeve me natyrë fetare, në rastet e deklaratave kontraversale në lidhje me fenë, historinë e saj dhe marrëdhëniet ndërfitare në Shqipëri, si dhe në rastet e skandaleve brenda komuniteteve fetare.

Raportimi i mediave kryesore për ceremonitë dhe aktivitetet që organizohen me rastin e festave të shënuara fetare, rezulton të jetë përgjithësisht korrekt dhe i balancuar për të gjitha fetë kryesore në vend. Por në një mënyrë stereotipike, pothuaj të gjitha mediat kryesore, i kushtojnë një vëmendje të madhe pjesëmarrjes dhe deklaratave në këto ceremoni të drejtuesve kryesorë të politikës dhe të shtetit.

Një problem i ngritur jo rrallë prej studjuesve, por edhe prej përfaqësuesve të klerit, është cektësia apo mungesa e profesionalizmit në rastin e raportimeve për fenë. Ekziston edhe një debat lidhur me prioritetet e axhendës së mediave që lidhet me fenë, ku nuk mungojnë edhe akuzat se mediat raportojnë për fenë më shumë në raste skandalesh. Gjithashtu nuk ekziston ndonjë rubrikë e veçantë apo ndonjë emision i dedikuar posaçërisht për informacionin dhe problemet që lidhen me fenë. Përsa i takon investigimit të mediave lidhur me

ekstremizmin fetar në vend, rezulton se ai është i varfër, i pamjaftueshëm dhe shumë sporadik.

Një nga pyetjet kërkimore në kuadër të këtij studimi kanë qenë: Nga pikëpamja sasiore, sa i pranishëm është diskursi ekstremist fetar në median shqiptare? Një monitorim i kryer nga Instituti Shqiptar i Medias që përfshiu mjedisin online në gjuhën shqipe si dhe gazetat “Panorama”, “Shqip” dhe “Tema” për një periudhë 4-mujore identifikoi një numër prej 284 materialesh, duke nisur nga materialet e moderuara deri tek materialet ekstreme. Një numër prej 201 materialesh u identifikuan në median online kurse 83 u identifikuan në shtyp. Nga 284 materiale të gjetura, 194 janë të kategorisë “E moderur”, 82 janë të kategorisë “Në zgrip, dhe vetëm 8 janë të kategorisë “Ekstreme”.

Po nga pikëpamja e kërkimit cilësor, cilat janë linjat kryesore të diskursit ekstremist në mediat shqiptare?

Një nga linjat kryesore të diskursit ekstremist fetar është ai që e konsideron identitetin fetar si prioritar në raport me identitetin kombëtar dhe identitetet e tjera. Historikisht dhe tradicionalisht në Shqipëri, identiteti kombëtar ka prevaluar mbi të gjitha identitetet e tjera, pasi është konsideruar si një njësi unifikuese e shqiptarëve, pavarësisht nga feja e tyre. Por nën interpretimin ekstremist salafist identiteti fetar është mbi identitetin kombëtar. Duke përdorur metrin fetar për të përcaktuar njësinë kombëtare, synimi i diskursit islamist është të promovohet krijimi i një shoqërie

në të cilën identiteti kombëtar duhet t'i nënshtrohet identitetit fetar. Një optikë e tillë do të ishte përçarëse dhe asgjësuese për shoqërinë multifetare shqiptare. Për këtë arsye çdo lloj pikëpamjeje që sfidon apo kërkon përmbysjen e raportit identitet kombëtar/identitet fetar në favor të këtij të fundit, për realitetin shqiptar konsiderohet si tendencë apo shfaqje e ekstremizmit.

Si pjesë e diskursit ekstremist fetar, në dekadën e fundit është zhvilluar edhe një lloj qasjeje që synon një ri-interpretim të historisë dhe vënie të saj nën optikën fetare. Një nga shfaqjet më të shpeshta të tij në shoqërinë shqiptare është debati që synon një rishikim të historisë së Shqipërisë në periudhën e sundimit otoman. Adhurimi i disa individëve ekstremistë për perandorinë otomane reflekton adhurimin për një shoqëri përtej kufijve kombëtarë, ku feja mbizotëruese ishte Islami dhe ku identiteti fetar ishte mbi atë kombëtar. Nostalgjia ndaj otomanizmit shpreh nostalgjinë për një nga përpjekjet e para të njohura në histori për të realizuar një lloj Kalifati, siç ishte perandoria otomane. Në situatat aktuale kjo nostalgji rezonon edhe me fushatën e islamit politik për krijimin e një mbretërie globale të qeverisur nga një interpretim i Sherihatit.

Nën optikën islamiste janë vënë edhe figura të tilla si Skënderbeu dhe Nënë Tereza që sipas ligjërimi ekstremist rezultojnë të jenë figura të përçarjes kombëtare dhe jo të unifikimit kombëtar, me argumentin se veprimtaria e tyre i përket apo është e lidhur me

fenë e krishterë. Në fakt shqiptarët i kanë adhuruar dhe lartësuar Skënderbeun dhe Nënë Terezën për origjinën e tyre shqiptare dhe jo për origjinën fetare. Kontributet e tyre ata i kanë parë si pjesë e krenarisë dhe e përkatësisë kombëtare dhe jo si pjesë e ndonjë lloj krenarie apo përkatësie fetare.

Një ri-intepretim i tillë i historisë kombëtare dhe i figurave emblematiche të saj është qartazi ekstremist dhe krahas mbjelljes së urrejtjes ndaj feve të tjera jo-muslimane, mbart edhe rrezikun e përçarjes kombëtare. Shqetësues është fakti që kjo retorikë ka gjetur vend edhe në disa media kryesore, të cilat iu lënë hapësirë të konsiderueshme intervistave me eksponentë të deklaruar të ekstremizmit, duke iu dhënë mundësinë që të përhapin mesazhet e tyre në një publik më të gjerë. Një politikë e tillë editoriale ka vend të analizohet dhe të rishikohet nga redaksitë e mediave, pasi është në kundërshtim me interesat jetike të publikut të gjerë, që është kundër çdo forme të ekstremizmit fetar dhe dëshiron e aspiron harmoninë dhe tolerancën fetare.

Në media raportohet me shqetësim edhe për promovimin e disa shkollave radikale në hapësirën fetare shqiptare siç është salafizmi dhe paraqitjen e tij si një alternativë ndaj traditës tolerante Hanefi të Islamit shqiptar.

Shqetësimi për shfaqjen dhe praninë e salafizmit në hapësirën fetare shqiptare nuk ka të bëjë thjesht me faktin se është shtuar edhe një shkollë tjetër e

intepretimit të Islamit. Duke shfrytëzuar faktin që kjo rrymë është pjesë e Islamit Sunit, të cilit i përket edhe shkolla tradicionale Hanefi e islamit shqiptar, imamët që predikojnë salafizmin po “pushtojnë” njera pas tjetrës xhamitë, madje edhe ato që janë nën kontrollin e KSHM dhe po depërtojnë me agresivitet edhe në rangjet drejtuese të komunitetit Islamik Sunit në Shqipëri e Kosovë.

Krahas zgjerimit të sferave të influencës dhe të kontrollit, salafistët po promovojnë edhe modelin shoqëror të Kalifatit. Kalifati është bërë pjesë e retorikës së individëve ekstremistë shqiptarë të shfaqur edhe në media. Në mediat online në gjuhën shqipe aktualisht është e pranishme gjithashtu një literaturë dhe një ligjërime i gjerë që u ofron besimtarëve myslimanë, por edhe të tjerëve, mënyrën islamiste të jetesës dhe të kuptuarit të botës. Edhe pse shqiptarët në Shqipëri, Kosovë dhe në Ballkan jetojnë në vende sekulariste ku vepron shteti ligjor dhe ku praktikohet mënyra liberal-demokratike e jetesës, këto websajta u ofrojnë atyre një alternativë tjetër: atë të Sherihatit.

Këto interpretime radikale janë të aplikueshme vetëm në vendet monofetare që dallohen për Islamit radikal dhe që nuk kanë asnjë lidhje me kontekstin shqiptar, ku ka ekzistuar një formë shumë tolerante e Islamit. Në Shqipëri dhe në përgjithësi në hapësirën shqiptare nuk kanë qenë të aplikueshme në masë shumë rregulla strikte të Islamit radikal. Gjithashtu në

Islamin shqiptar nuk ekzistojnë ose janë tepër të zbehta antisekularizmi, totalitarizmi apo anti-oksidentalizmi, që janë tipare të qenësishme të Islamit radikal dhe të salafizmit. Në këto kushte, për kontekstin shqiptar, propaganda apo qasjet që nxisin aplikimin e rregullave strikte dhe të një forme radikale të Islamit në Shqipëri, nuk mund të jetë veçse një propogandë ekstremiste.

Nga monitorimi i mediave në Shqipëri është verifikuar edhe prania e nje diskursi që lidhet me islamofobinë. Diskursi rreth Islamofobisë është relativisht i ri në mjedisin shqiptar. Ai paraqitet si pjesë e ligjërimit fetar, politik dhe mediatik. Ajo që është shqetësuese në kontekstin shqiptar është përdorimi i Islamofobisë si pjesë e ligjërimit ekstremist islamist dhe si alibi për të maskuar apo për të mbështetur propogandën dhe veprimtarinë ekstremiste.

Përsa i takon diskursit anti-perëndimor dhe anti-amerikan, ai rezulton të jetë i frymëzuar apo i gjeneruar nga ekstremizmi fetar dhe është një dukuri që ka lindur gjatë dy dekadave të fundit, pikërisht në kohën kur në vend depërtuan shkollat radikale të mësimin të Islamit, dhe bashkë me to edhe idetë dhe propaganda islamiste. Analiza e përmbajtjes së disa shkrimeve të botuara në shtyp dhe në median online, zbulon praninë e këtij diskursi edhe në komunikimin masiv publik që zhvillohet në Shqipëri.

Brenda këtij diskursi dallohen përpjekjet e disa autorëve apo individëve ekstremistë për të fajësuar Perëndimin dhe SHBA për të gjitha konfliktet, luftërat dhe gjer tek krijimi i ISIS apo aktet terroriste që ndodhin kudo në botë.

Në disa raste termat e urrejtjes dhe të anatemimit ndaj Perëndimit janë në të njëjtën lartësi amplitude me termat e përdorura nga ekstremistët në Lindjen e Mesme apo rezonojnë me disa nga tezat kryesore të propogandës së ISIS, duke verifikuar kështu praninë e argumenteve apo të refleksive të kësaj propagande në hapësirën shqiptare.

Por diskursi anti-perëndimor dhe anti-amerikan shfaqet edhe si refleks apo ndikim i ideologjive të ekstremit të majtë, të cilat vijojnë të jenë të pranishme në vend, edhe pse ka kaluar më shumë se një çerek shekulli nga rënia e komunizmit.

I pranishëm në media është edhe një diskurs i përgjithshëm anti-luftë, që në thelb është kundër ndërhyrjes ushtarake të Perëndimit në konfliktin e krijuar nga ISIS. Në kuadër të diskursit anti-perëndimor nuk mungojnë edhe shkrimet që botojnë apo trajtojnë supozime dhe teori konspiracioni, sipas të cilave mjaft akte terroriste mund të jenë organizuar nga agjenturat perëndimore, për të nxitur urrejtjen ndaj Islamit dhe myslimanëve.

E inkuadruar në diskursin ekstremist anti-perëndimor paraqitet edhe teza e standarteve të dyfishta.

Sipas kësaj teze, shoqëritë dhe mediat perëndimore trajtojnë me standarte të dyfishta aktet terroriste që kryhen në Europë dhe ato që kryhen në Lindjen e Mesme apo në vende të tjera jo perëndimore të botës dhe “pikërisht ky standard i dyfishtë po e shkatërron botën.”

Mjaft problematik në kuadrin e diskursit ekstremist mbetet diskursi që justifikon, glorifikon dhe promovon dhunën ekstreme. Duhet theksuar se ky lloj diskursi është i denoncuar nga mediat shqiptare dhe jo pjesë e përmbajtjes së tyre. Gjithashtu ai është shumë i kufizuar.

Si përfundim mund të themi se krahas raportimit dhe denoncimit të ekstremizmit fetar, media duhet të aplikojë edhe një politikë editoriale që ia kufizon hapësirën diskursit ekstremist dhe i zgjeron hapësirën promovimit të tolerancës dhe të harmonisë fetare.

BIBLIOGRAFI

Analizë e diskursit ekstremist fetar në media, ISHM, Tiranë, 2016

Fico, Delina, *Dialogu dhe bashkëpunimi ndërjetar në shërbim të harmonisë fetare në Shqipëri*, Në: *Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri*, faqe 45-46, Tiranë 2010

Fuga, Artan, *Komunikimi në shoqërinë masive*, Papirus, Tiranë, 2014

Jung, Siegfried, *Skanderbegs Erben, Christen in Albanien*, Uhidingen: Stephanus Edition Verlag GmbH, 1990

Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, AIIS, Tiranë, 2015

Holbrook, Donald, *Designing and Applying an "Extremist Media Index"*, Perspectives on Terrorism Volume 9, Issue 5, 2015

Merdani, Arlinda, *Marrëdhëniet ndërjetare në Shqipëri*, Onufri, Tiranë, 2014

Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Shtëpia botuese Elena Gjika, Tiranë

Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri, IDM, 2015

Rakipi, A. *Lindja e një ndikimi të ri radikal në Shqipëri*.
Gazeta Mapo. <http://www.mapo.al/2015/03/lindja-e-nje-ndikimi-te-ri-radikal-fetar-ne-shqiperi> (2015, 21 Mars)

Religious fundamentalism and radicalisation,
Parlamenti European, European Parliamentary Research
Service, Autore: Anita Orav

Roy, Olivier, *Globalizimi i Islamit*, Botimet IDK,
Tiranë, 2011

Skendi, Stavro, *Crypto-Christianity in the Balkans
under the Ottomans*, Slavic Review 26, nr. 2, faqe 227-
246, Qershor 1967

Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy
of the United Kingdom, 2008